

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7763 E martë 15 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Në shtator 2013, tepsia me dy garuzhde rrinte disi e ngushtë për orxket e dy garuzhdembajtësve. Privatizime strategjike nuk kishte më. Koncesionet ...
Vijon në faqen 20

Nga FATOS ÇOÇOLI

Tepsi, timon dhe kadri


Opinion i Ditës

Mbi 500 vjet pas dilemës pro-verbiale hamletiane "To be or not to be" sot në Britaninë e Madhe shtrihet çështja tjetër problematike "të jesh apo ..."
Vijon në faqen 21

Nga JORGJI KOTE

Dilemat hamletiane të Brexit




Zëri i Amerikës/ Përgjimet e Arben Çukos

Farsa e konkurseve, shefja e kabinetit të Ramës ndërhyjnë për emërimet në Burgje

Bisedat mes ish-drejtorit dhe Vali Bizhgës për punësim. Rama sulmon VOA: Flet nga kazani

ALEKSANDRA BOGDANI

Më 30 prill 2018, drejtori i Përgjithshëm në atë kohë i Bur-geve, Arben Çuko mori një telefonatë nga kabinetet e kryeministrit Edi Rama. Biseda bëhej me porosi të drejtoreshës së kabinetit, Vali Bizhga dhe kishte ...
Në faqen 8

KRYEMINISTRI: DO E DREJTOJ MEPJ. PRESIDENTI: VENDOS BRENDË 7 DITEVE

RAMA: UNE KRYEDIPLOMAT, META: ME DUHET PAK KOHË

Kreu i qeverisë do bëhet edhe ministër i Jashtëm: Me Metën do të takohem në Kushtetuese. Presidenti: Problemi i tij, nuk respekton institucionet



(Në foto) Presidenti, Ilir Meta dhe Kryeministri, Edi Rama

U HOH MBI KANGJELLA

Krimi në familje, dhëndri vret me armë vjehrrin, vjehrrën dhe veten
Në faqen 7

PASAPORTA SHQIPTARE

Shtetësia, të huajt japin provim gjuhe. Lehtësohet procesi për kosovarët
Në faqen 5

UNAZA E RE

PD: Si ndryshuan kriteret në tender, fituesi i garës është i paracaktuar
Në faqen 4

PROCEDURA

Emigrantët në Greqi, aplikimet për të përfutur nënshetësinë
Në faqen 11

DYSHIMET



Atentat në Vlorë, dy të rinj me motor plagosin me armë 41-vjeçar
Në faqen 6

Dossier/ Rrëfimi i Uran Butkës: Peripecitë kur refuzova të recitoj "Epopenë e Ballit"

"Si i shpëtova arrestimit nga fjala e Pirro Kondit"

Djali: Safet Butka tha "nuk kemi dalë në luftë të vrasim shqiptarë"

NGA DASHNOR KALOÇI

Historian, studiues, publicist, shkrimtar, piktor, politikan dhe ish-deputet, Uran Butka, një nga personazhet publike mjaft të njohur pas viteve '90-të, edhe pse mban plot tetë dekada mbi supë, vazhdon përsëri



të punojë, madje me energji të jashtëzakonshme sikur kërkon t'i bëjë sfidë jo vetëm moshës, por edhe gjithë asaj periudhe kohe të errët për të, të para viteve '90-të, kur regjimi komunist ua kishte privuar të drejtën e shkrimeve, studimeve dhe librave, prej ...
Në faqen 16-17

DIPLOMACIA KONFLIKTI

Presidenti: Gent Cakaj, figurë krejt e panjohur për opinionin publik

Meta: Rama ministër i Jashtëm? Më duhet pak kohë, brenda javës

"Kryeministri nuk respekton institucionet"

Presidenti Ilir Meta tha dje në "Opinion" të Blendi Fevziut se do të marrë një vendim brenda 7 ditëve për propozimin e Edi Ramës si ministër i Jashtëm. Megjithatë, kreu i shtetit nuk u shpreh nëse do ta dekretojë apo jo atë në krye të diplomacisë.

Kryeministri ka deklaruar se do të marrë vetë përsipër postin e ministrit të Jashtëm. Ky është lajmi më i fundit. Çfarë qëndrimi keni?

Është një lajm i freskët dhe mesa jam në dijeni, pak më parë ka mbërritur apo është protokolluar një propozim i tillë, për të cilin natyrisht që më duhet një kohë e mjaftueshme për t'u kështilluar dhe për të dhënë një vlerësim të plotë.

C'do të thotë një kohë e mjaftueshme, zoti President? Për çfarë do të këshilloheni ju për Edi Ramën?

Besoj se kohë e mjaftueshme do të thotë që çdo veprim të bëhet me përgjegjshmëri, duke respektuar Kushtetutën dhe duke marrë në konsideratë çdo kërkesë të vetë Kushtetutës.

A do të përdoren kriteret që janë përdorur edhe në rastin e Cakajit për Ramën? Që do të thotë, a do të shihet edhe përmbajtja e deklaratave të tij lidhur me qëndrimin për shembull ndaj shkëmbimit të territoreve, idesë së shkëmbimit të territoreve midis Kosovës dhe Serbisë dhe qëndrimi i diplomacisë shqiptare në këtë drejtim?

Jua thashë edhe një herë që një kërkesë e tillë sapo është depozituar dhe do të kërkojë kohën e saj. Dhe përgjigjja do të jetë tepër e përgjegjshme, por edhe transparente.

Së dyti, nuk mund të bëjmë një paralelizëm të rastit të kandidatit të mëparshëm me kandidatin e vetëpropozuar, për arsye se në rastin e dytë kemi të bëjmë me një figurë të njohur politike, ndërsa në rastin e parë kishim të bënim



Presidenti Ilir Meta

TENSIONI

"Nuk ekziston asnjë problem personal. Problemi është që zoti Rama nuk i respekton dot institucionet. Për të, çdo gjë që i pëlqen është kushtetuese dhe e ligjshme. Çdo gjë që nuk i pëlqen është anti-kushtetuese dhe e paligjshme".



Presidenti Ilir Meta dhe kryeministri Edi Rama

REAGIMI I EDI RAMES

"Erdhi dita që Zëri i Amerikës të flasë nga kazani i Tiranës, duke përgojuar dynjanë mbi bazë llogjesh telefonike. Për herë të parë në Albania organizohet konkurs publik për punësimet në burje dhe kazani gjëmon deri në Amerikë e jehon në katundin tonë mediatic. Çfarë katandie", shkruan Rama në "Facebook".

Soreca e Borchardt: Përbushni kriteret për negociatat

Ambasadorët e BE dhe OSBE takojnë Bashën: Kthehu në Kuvend

Ambasadori i Bashkimit Evropian dhe ai i OSBE-së i kërkuar dje kreut të opozitës, Lulzim Bashës, rikthimin në Kuvend për reformën zgjedhore. Në këtë mënyrë, Bashkimi Evropian ka shtuar presionin ndaj politikës shqiptare për miratimin e reformës zgjedhore. Me nisjen e sesionit të ri parlamentar, ndërkombehtarët duken të shqetësuar edhe për qëndrimin e opozitës, nëse ajo do të rikthehet në institucione për ta vijuar dialogun politik dhe përmbyllur reformën zgjedhore. Ambasadori i BE-së, Luigi Soreca dhe ai i OSBE-së, Bernd Borchardt ishin dje në zyrën e Lulzim Bashës, për t'i kërkuar rikthimin në parlament dhe kontributin për ligjin zgjedhor. Dy ambasadorët, ai i BE-së, Luigi Soreca dhe i OSBE-së, Bernd Boshard dolën optimistë nga takimi me kreun e opozitës, duke u kujtuar palëve se pavarësisht ngushtimit të afateve ko-



Kreu i opozitës, Lulzim Basha

hore, nëse kanë vullnet politik, mund t'ia dalin mbanë. "Opozita i përket parlamentit dhe kjo është një kërkesë konstante që i bëjmë opozitës dhe ne shpresojmë që opozita të jetë në parlament, si në dhjetor. Objektivi është të finalizohet puna e bërë në dokumentin, në propozimet e përbashkëta që përbushin rekomandimet

Zoti President, a ka një raport të tensionuar mes jush dhe zotit Rama?

Për mua nuk ekziston asnjë problem personal. Problemi është që zoti Rama nuk i

respekton dot institucionet. Për të, çdo gjë që i pëlqen është kushtetuese dhe e ligjshme. Çdo gjë që nuk i pëlqen është anti-kushtetuese dhe e paligjshme.

respekton dot institucionet. Për të, çdo gjë që i pëlqen është kushtetuese dhe e ligjshme. Çdo gjë që nuk i pëlqen është anti-kushtetuese dhe e paligjshme.

një seri takimesh me faktorët politikë, për t'i nxitur për reformën, e cila është kusht për integrimin. Kreu i delegacionit të Bashkimit Evropian në vendin tonë, Luigi Soreca, tha se takimi me Bashën është në vazhdim e takimeve me përfaqësues të tjerë politikë. Kreu i delegacionit të BE-së në Tiranë përmendi se reforma zgjedhore mbetet prioritet për hapjen e negociatave. "Ishim me kolegjin Borchardt për të biseduar për reformën zgjedhore, që përfaqëson për ne ende një prioritet, pjesë të prioritetëve që Shqipëria duhet të përbushë para vendimit të qershorit lidhur me hapjen e negociatave. Ne flasim me të gjitha partitë dhe nuk do të ndalojmë së kërkuarit të gjitha partive që të bëjnë punën e tyre në kuptimin e përbushjes së përgjegjësisë", theksoi z. Soreca.

Por kur e keni mësuar këtë gjë të zotit Rama? Është diçka e re apo kështu e ka pasur gjatë gjithë karrierës së tij politike?

Prisim të përmirësohej.



200 milionë dokumente të Arkivës Shtetërore dixhitalizohen

Mbi 200 milionë dokumente arkivore për shqiptarët dhe historinë e shtetit shqiptar janë të aksesueshme "online" pas dixhitalizimit të dokumenteve arkivore. Paralelisht ambjentet e arkivës i janë nënshtruar rikonstruktimit total. Kryeministri Edi Rama dje vizitoi ambjentet e reja, u njoh me investimet e kryera në këtë institucion që e kanë modernizuar dhe transformuar. Rama premtonte mbështetje për të krijimin e një hapësire edhe për dokumentet origjinale që ndodhen në ambjentet e arkivës të vendosura në zonën e Shkozës. Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave është pajisur edhe me laboratorin i ri të restaurimit. Një investim i bërë në kuadrin e Vitit të Skënderbeut dhe ka të bëjë pikërisht me ruajtjen e dokumenteve dhe restaurimin e tij.



Kreu i qeverisë ka pranuar zgjidhjen e ofruar nga Meta, do drejtojë vetë diplomacinë

Rama, edhe ministër i Jashtëm: Me Metën takohem në Kushtetuese

Vendimi u mor në mbledhjen e kryesisë

Kryeministri Edi Rama nuk ka preferuar ta çojë më tej përplasjen institucionale me Presidentin e Republikës për çështjen e dekretit për emërimin e ministrit të Jashtëm dhe në mungesë të Gjykatës Kushtetuese, ka zgjedhur si rrugëdalje nga ky ngërc pikërisht që këtë institucion, të paktën formalisht, ta drejtojë vetë. Vendimi është diskutuar dhe në mbledhjen e kryesisë së Partisë Socialiste, ku Rama mësohet se ka hedhur në tryezë dy variante për diskutim. Kështu, mes variantit për t'i ripropozuar Presidentit Ilir Meta sërish emrin e Gent Cakajt dhe atij që postin e ministrit të Jashtëm ta merrte vetë, ka fituar ky i dyti. Lajmi qarkulloi dhe gjatë kohës që zhvillohej mbledhja e kryesisë fillimisht në media dhe më pas ishte vetë kryeministri, Edi Rama ai që nëpërmjet një komenti në rrjetet sociale, konfirmoi këtë zgjidhje të detyruar. "Do të jem de jure në këtë rol, sepse s'kemi kohë për të humbur në kërkim të Presidentit", - shkroi Rama në mesazhin e vet. Por ai nuk nguroi që sërish të tregonte se kjo ishte një tërheqje e përkohshme e tij dhe se betejën me Presidentin e Republikës do ta vazhdojnë në Gjykatë Kushtetuese. Sipas tij, kreu i shtetit edhe një herë tjetër me mosdeklarimin e propozimit për shkarkimin e ministrit të Jashtëm, Ditmir Bushati, kishte shkelur sërish kushtetutën. "Presidenti s'e ka ç'dekretuar ministrin e Jashtëm në afatin kushtetues. Shkelje e radhës që do ta ballafaqojmë bashkë me të tjerat në Gjykatën e re Kushtetuese", - shprehej më tej Rama në mesazhin e tij. Por deri atëherë, pra deri kur Gjykata Kushtetuese të rringrihet, Rama theksonte se do ta merrte vetë detyrën e shefit të diplomacisë. Por kjo siç bëri të ditur ai vetëm "de jure", duke lënë të kuptohet qartë se "de facto" këtë rol do ta luante pikërisht Gent Cakaj, i cili mban edhe pozicionin e zëvendësministrit për Europën dhe Punët e Jashtme. Por i menjëhershëm ka qenë dhe edhe reagiimi i Presidentit të Republikës, Ilir Meta, i cili po nëpërmjet një statusi në rrjetet sociale i kujtonte Ramës se kishte iku koha



Kryeministri Edi Rama gjatë një takimi me ministrat në Elbasan

VENDIMI
"Presidenti s'e ka ç'dekretuar ministrin e Jashtëm në afatin kushtetues. Shkelje e radhës që do ta ballafaqojmë bashkë me të tjerat në Gjykatën e re Kushtetuese. Deri atë ditë që vjen shumë shpejt, do të jem de jure në këtë rol, sepse s'kemi kohë për të humbur në kërkim të presidentit".

Precedentët, 6 kryeministra kanë qenë edhe ministra të Jashtëm

Kryeministri Edi Rama do jetë edhe ministër i Jashtëm, nëse presidenti Meta e dekreton. Por ky nuk është rasti i parë kur kryeministri ka marrë përsipër edhe rolin e ministrit të Jashtëm. Instituti i Studimeve Politike ka publikuar dhe 6 precedentët që nga viti 1912 dhe deri më sot, ku kryeministri ka mbajtur edhe detyrën e një ministri. Megjithatë, thuhet se kjo gjë ka ndodhur në situata të jashtëzakonshme apo për periudha shumë të shkurtra kohore. Instituti i Studimeve Politike (ISP) paraqet rastet në 107 vjet, por në tërësi, kanë qenë kabinete në situata të jashtëzakonshme (1912, 1914, 1921, 1944) apo për periudha shumë të shkurtra kohore. Përjashtim bën periudha 1946-1953 kur kryeministri Enver Hoxha mbante të gjitha postet e rëndësishme në parti, shtet dhe në qeveri, - një tipar i partive shtet. Në rastet e tjera jetëgjatësia e këtij eksperimenti ka qenë me disa muaj. I tillë mund të jetë edhe tani.



A do rikandidojë Veliaj? Balla: Ka justifikuar besimin e dhënë

Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla shprehet se kryebashkiaku aktual i Tiranës, Erion Veliaj e ka justifikuar plotësisht besimin e dhënë nga partia dhe qytetarët e Tiranë në këto 4 vite, por nuk është i gatshëm të konfirmojë se ai është kandidati që do përfaqësojë sërish socialistët në zgjedhjet e 30 qershorit. Në një intervistë për "News 24", Balla theksoi se PS-së i duhen kandidatë që i mbështet komuniteti. "Do kemi 61 kandidatë në 61 bashkitë e vendit, për të cilët kemi përcaktuar një axhendë shumë të mirë për sa i përket marrjes së mendimit të komuniteteve. Ne kemi krijuar modele të shkëlqyera të qeverisjes vendore, goftë me Edi Ramën, por edhe tashmë në qeverisjen vendore, ku ndër to spikat në mënyrë të veçantë kryetari i bashkisë së Tiranës Erion Veliaj, i cili e ka justifikuar besimin e dhënë nga ne, por pikë së pari besimin e dhënë nga qytetarët shqiptarë në 4 vite. Por askush prej nesh nuk ka të drejtë të dalë mbi vendimet e përbashkëta e kolegjiale të PS-së që në momentin e duhur do të flasin për vendimet", - tha Balla.



Votimi i ndryshimeve në qeveri, Kuvendi mund të mbledhet nesër

Mazhoranca pritet të mblidhet në Kuvendin të nesërmen në mbledhjen e Kuvendit në seancë të jashtëzakonshme për të votuar dekretet për shkarkim dhe emërim ministrash. Ndonëse nuk ka ende një urdhër të nxjerrë nga kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, burime nga shumica qeverisëse kanë bërë me dije se seanca mund të mbahet gjatë ditës së nesërme. Por kjo është në varësi të vendimit që do të marrë presidenti Meta për të dekretuar të paktën brenda ditës së sotme shkarkimin e Bushatit dhe emërimin e Ramës si ministër i Jashtëm. Kjo, pasi shumica qeverisëse ka vendosur dhe në kryesi që dekretet t'i votojë në bllok dhe jo të ndarë. Por mbledhja e Kuvendit gjatë ditës së nesërme është edhe një detyrim kushtetues për



mazhorancën, kjo pasi nesër mbushen 10 ditë kohë nga mbërritja e dekreteve të para të Metës për shkarkim dhe emërim ministrash në Kuvend. Bëhet fjalë për grupin e parë të dekreteve të nxjerrra nga Meta të shtunën e datës 5 dhjetor. Por, ndonëse dekretet janë shpallur në datë 5 janar, sipas mazhorancës, afati i tyre llogaritet me kohën e

mbërritjes në Kuvend. Dhe sipas burimeve nga Kuvendi, ato kanë mbërritur në protokollin e këtij institucioni vetëm të hënën e 7 janarit. Duke llogaritur që Kushtetuta i jep Kuvendit vetëm 10 ditë kohë për miratimin e një dekreti për shkarkim apo emërim ministri, ky afat skadon pikërisht ditën e nesërme.

shtetit fals. "Presidenti në krye të punës. Për presidentin e para është Kushtetuta dhe sundimi i ligjit. 'No more fake state'. Shqipëria e Para!", shkroi kreu i shtetit në replikën e radhës me kreun e qeverisë. Ndërkohë që kryeministri Rama menjëherë pasi bëri të ditur vendimin e tij, dërgoi në Presidencë dy propozimet e reja, atë për emërimin e tij edhe si ministër i Europës dhe Punëve të Jashtme, por edhe kërkesa për herën e dytë për të shkarkuar ministrin në

detyrë, Ditmir Bushati. Edi Rama i dërgoi Presidentit të premtën e 4 janarit kërkuesin për shkarkimin e 7 ministrave, si dhe Zv.kryeministres, si dhe emërimin e zëvendësuesve të tyre. Ilir Meta dekretoi të gjitha propozimet e kryeministrit Rama, përveç atij të shkarkimit të ministrit të Jashtëm, Ditmir Bushatin dhe emërimit të Genti Cakajt në vendin e tij, çka u bë shkak për një përplasje të fortë institucionale mes 2 krerëve më të lartë të shtetit, që u pasua edhe me akuzën po kaq të

forta personale. Me propozimin për ta drejtuar vetë Ministrinë e Jashtme, Rama duket se ka gjetur zgjidhje momentale për ngërcin e krijuar, ndërsa pritet ta çojë konfliktin e përsëritur tashmë në Gjykatë Kushtetuese. Për koicidencë Edi Rama nuk është i vetmi kryeministër në rajon që njëkohësisht do të drejtojë dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme. Përveç tij edhe Aleksis Tsipras në Greqi, drejton Ministrinë e Jashtme pas dorëheqjes së Nikos Kotzias.

SKANDALI UNAZA

PD nxjerr dokumentet: Manipulimi, për të favorizuar klientin e qeverisë

Ofertat e garës për 'Unazën', PD: Si ndryshuan kriteret e tenderit

"Fituesi i tenderit, i paracaktuar"

Valentina Madani

Partia Demokratike akuzoi kryeministrin dje Edi Rama se ka paracaktuar fituesin e ri të Unazës së Re. Partia Demokratike publikoi dje të tjera dokumente, sipas të cilave, thellojnë akoma më shumë skandalin e ARRSH-së me aferën e Unazës së Madhe. Përmes dokumenteve të publikuara nga Departamenti i Antikorupsionit, PD pretendon se ARRSH ka ndryshuar kriteret për të favorizuar firmën "Gjoka Konstruksion", në lotin e parë të Unazës së Madhe, që shtrihet nga Pallati me shigjeta të ish-rrethrotullimi "Shqiponja". Sipas drejtueses së Departamentit për Antikorupsionin në PD, Lealba Penlinku, firma fituese është "Gjoka Konstruksion", kompani kliente e qeverisë. Projekti korruptiv 20 milionë euro për kilometër duhet anuluar i gjithi, sipas saj, ndërsa i bën thirrje prokurorisë të hetojë dhe të çojë para drejtësisë ata që po vjedhin me tendera fasadë. "Në përgjigje të reagimit të dëshpëruar të Autoritetit Rrugor Shqiptar, ky i fundit, meqë ka marrë përsipër barrën e rëndë të pastrojë të pastrueshmet e kryeministrit-urdhërues, duhet të sqarojë përse gënjën publikisht kur deklaruan se kriteret dhe kërkesat ligjore në këtë garë, të publikuara edhe në Agjencinë e Prokurimit Publik janë të njëjta me ato të garës së mëparshme për të njëjtin lot të Unazës dhe nuk ka ndryshuar asnjë prej tyre?". Përse kriteri për paraqitjen e licencës u ndryshua nga licenca NP - 12/G Punime të inxhinierisë së mjedisit, në licencën NP - 12/F Punime të inxhinierisë së mjedisit? Në tryezën e pazarit është vënë licenca që "Gjoka Konstruksion" disponon, pra NP - 12/F Punime të inxhinierisë së mjedisit dhe kjo e ka shtyrë ARRSH të rrëshqasë në rrjedhën e paligjshmërisë së nisur në shtator 2018", deklaroi zj.Pelinku. Sipas saj, kompania fituese është paracaktuar nga kreu i ekzeku-



Projekti i Unazës së Madhe

AKUZA

"Kompania 'Gjoka Konstruksion' është paracaktuar të shpallet fituese e një tenderi të manipuluar përmes kriterëve shumë specifike dhe të pakapshme nga shumica dërrmuese e kompanive të ndërtimit. Askush nuk ka më dyshim se Edi Rama është ai që ka urdhëruar këtë projekt të zhvatjes së shqiptarëve, 20 milionë euro për 2.3 kilometra", tha Pelinku.

'UNAZA', KOMPANITË QË KANË DORËZUAR OFERTA

1. Curri sh.p.k. & Vëllëzërit Hysa sh.p.k. & Agri Konstruksion
2. GD Granit AD Skopje
3. Gjoka Konstruksion SH.A. & Shansi invest sh.p.k.
4. Geci sh.p.k.
5. ANK sh.p.k.
6. Bafjar Murati

KRITERET SI ISHIN KRITERET SI BËHEN

miratimi e rregullimit për kriteret dhe procedurat e licencës së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi". Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara në sa me sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- NP - 1/C Punime germimi në toke.
- NP - 4/G Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- NP - 5/G Punime nentokesore, ura e vepra arti.
- NP - 9/C Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonfikime.
- NP - 11/C Ndertime për N/Stacione, kabina e transformatoreve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarja e energjisë.
- NP - 12/G Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- NS - 1/C Punime për prishjeve e ndërtimeve.
- NS - 6/A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
- NS - 7/A Bariera dhe mbrojtje rrugore
- NS - 8/D Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
- NS - 9/D Punime strukturore speciale
- NS - 10/G Shtresa dhe mbistruktura speciale.
- NS - 13/F/ Impiante dhe Linja telefonie dhe telekomunikacioni.
- NS - 18/ D Punime topogjeodezike.
- NS - 20/D Shpime gjeologjike - inxhinierike, puse e shpime për ujë.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008).

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Per kete duhet te

licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara në sa me sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- NP - 1/C Punime germimi në toke.
- NP - 4/G Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- NP - 5/G Punime nentokesore, ura e vepra arti.
- NP - 9/C Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonfikime.
- NP - 11/C Ndertime për N/Stacione, kabina e transformatoreve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarja e energjisë.
- NP - 12/F Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- NS - 7/C Punime për prishjeve e ndërtimeve.
- NS - 6/A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
- NS - 7/A Bariera dhe mbrojtje rrugore
- NS - 8/D Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
- NS - 9/D Punime strukturore speciale
- NS - 10/G Shtresa dhe mbistruktura speciale.
- NS - 13/F/ Impiante dhe Linja telefonie dhe telekomunikacioni.
- NS - 18/ D Punime topogjeodezike.
- NS - 20/D Shpime gjeologjike - inxhinierike, puse e shpime për ujë.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008).

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Per kete duhet te paraqese deshmë për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik.

titiv, duke e cilësuar fasadë hapjen nga ana e Autoritetit Rrugor të ofertave për ndërtimin e lotit të parë të Unazës së Madhe. "Kompania 'Gjoka Konstruksion' është paracaktuar të shpallet fituese e një tenderi të ma-

nipuluar përmes kriterëve shumë specifike dhe të pakapshme nga shumica dërrmuese e kompanive të ndërtimit. Askush nuk ka më dyshim se Edi Rama është ai që ka urdhëruar këtë projekt të zhvatjes së shqiptarëve, 20 milionë euro për 2.3 kilometra". U shpreh zyrtarja e PD-së. PD kërkoi që projekti korruptiv 20 milionë euro për kilometër duhet anuluar i gjithi. "Prokuroria të hetojë dhe të çojë para drejtësisë ata që po vjedhin me tendera fas-

Protesta e banorëve të "Astirit": Rama e ka vendin në burg

Banorët e zonës së "Astirit" tek Unaza e Re vijuan edhe dje protestën në ditën e 72 të saj. Njëzëri banorët, thirrën: "Shtëpitë tona nuk i prishni dot, janë ndërtuar me gjak". Ndërkohë, në mesazhet e tyre, banorët shpreheshin: "O kryeministër nuk të do njeri, e ke vendin në burg. Firmose anulimin e projektit. Harroje, nuk i prish dot shtëpitë tona". Ndërkohë, fjalimet e njërit-tjetrit, banorët i shoqëronin me parulla të ndryshme si... "Edi Rama, Erion Veliaj, ikni nga Shqipëria". "Edi Rama o zagar, do të tërheqim me litar". Edhe në protestën e djeshme, deputetët e opozitës ishin në mbështetje të banorëve të "Astirit", të cilët kërkojnë anulimin e projektit që u prish banesat e tyre.

Kjo firmë dorëzoi në Shqipëri bilanc të falsifikuar për tri vitet e fundit, kur në fakt ishte krijuar më 25 qershor të 2018-ës, si dhe një dokument të sekretarit të Shtetit të Delaware në SHBA, se nuk kishte detyrime.



Ndryshojnë kriteret e dhënies së shtetësisë shqiptare, gjuha dhe historia janë kusht

Shtetësia, të huajt duhet të japin provimin e gjuhës shqipe

Lehtësohet procedurat për kosovarët

Asnjë i huaj nuk mund të marrë më shtetësinë shqiptare në rast se nuk zotëron gjuhën shqipe dhe një histori të Shqipërisë të certifikuar nga një institucion i posaçëm arsimor shqiptar. Ministria e Brendshme ka hartuar një projektligj të ri me anë të të cilit synon të shtrojë kriteret ligjore të përfitimit të shtetësisë shqiptare për të gjithë të huajt. Ndërkohë që lehtëson kriteret dhe kushtet e dhënies së shtetësisë për të gjithë ata qytetarë që kanë origjinë shqiptare, përfshi këtu edhe kosovarët. Për ta mbetur vetëm kriteri që të vërtetojnë origjinën shqiptare deri në dy breza si dhe të mos përbëjnë rrezik për Shqipërinë.



Ministri i Brendshme Sandër Lleshaj

EMIGRANTËT

Nëpërmjet këtij projektligji sanksionohet fitimi i shtetësisë shqiptare i të gjithë personave mbi 18 vjeç, të cilët kanë lindur jashtë territorit të RSH nga prindër shqiptarë, apo qoftë edhe njëri prind shqiptar, por që para kësaj moshe nuk janë regjistruar në zyrat e gjendjes civile në Shqipëri

PROJEKTILIGJI

Projektligji i hartuar nga qeveria dhe i hedhur për diskutim mes institucioneve të ndryshme qeveritare dhe partnerëve të huaj parashikon se shtetësia shqiptare fitohet tashmë nëpërmjet 4 mënyrave: lindjes, origjinës, natyralizimit dhe birësim. Sa i përket mënyrës së parë, pra asaj nëpërmjet lindjes, nisim ligjore kërkon t'i japë zgjidhje një problematike të zgjatur dhe që prekte kryesisht fëmijët e emigrantëve shqiptarë apo të atyre fëmijëve që janë lindur nga një çift ku njëri nga prindërit është shqiptar. Tashmë nëpërmjet këtij projektligji sanksionohet fitimi i shtetësisë shqiptare i të gjithë personave mbi 18 vjeç, të cilët kanë lindur jashtë territorit të RSH nga prindër shqiptarë, apo qoftë edhe njëri prind shqiptar, por që para kësaj moshe nuk janë regjistruar në zyrat e gjendjes civile në Shqipëri. Projektligji parashikon si një nga mënyrat e fitimit të shtetësisë shqiptare edhe atë nëpërmjet origjinës, që është lidhja familjare deri në dy shkallë e kërkuar me të paralindurit me shtetësi shqiptare, duke i dhënë mundësinë dhe asaj pjesë të popullit shqiptar që jeton jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, si pjesës që ka emigruar në mënyrë të hershme, por dhe pjesës që ka emigruar pas ndryshimeve që ndodhën në vendin tonë, pas viteve '90, dhe që dëshirojnë të kenë një lidhje të qëndrueshme juridike me shtetin shqiptar, por që njëkohësisht kanë mbajtur

Tarifa e aplikimit propozohet të shkojë në 300 euro

Afro 1 mijë persona aplikojnë mesatarisht në vendin Atone brenda një viti për shtetësinë shqiptare. Siç bëhet e ditur në dokumentacionin shoqërues të projektligjit "Për shtetësinë", i cili i referohet të dhënave të Sektorit të Shtetësisë për vitin 2018 kanë aplikuar rreth 1 mijë persona, nga të cilat 700 kanë aplikuar brenda vendit dhe 300 jashtë vendit. Aktualisht, tarifa e shërbimit (aplikimi për shtetësinë) është në masën 5 000 lekë për personat që aplikojnë brenda vendit, dhe 30 euro për personat që aplikojnë pranë përfaqësive diplomatike. Për vitin 2018 të ardhur atë për Buxhetin e Shtetit ishin vetëm 4.7 milionë lekë. Ndërkohë që me miratimin e ligjit të ri parashikohet që numri i aplikantëve të jetë rreth 1 500 persona në vit, ndërsa tarifa për aplikim propozohet të jetë në vlerën 300 euro, referuar edhe tarifave që zbatohen në nivel rajonal. Si rrjedhojë të ardhurat që parashikohen për Buxhetin e Shtetit, nëse kjo tarifë miratohet janë në vlerën 63 milion lekë.



Bełimi për marrjen e shtetësisë para kryetarit të bashkisë

Në nenin 17, të projektligjit është parashikuar kryerja e bełimit të personit që ka fituar shtetësinë shqiptare, me natyralizim apo origjinë, para kryetarit të bashkisë, për besnikëri ndaj shtetit shqiptar dhe për respektimin e Kushtetutës dhe legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Moskryerja e kësaj procedure krejt formale passjell shfuqizimin e dekretit për dhënien e shtetësisë shqiptare.



Projektligji, presidentit i lihet vetëm 60 ditë kohë

Drafti i hartuar nga Ministria e Brendshme përcakt ton në mënyrë kronologjike dispozitat në lidhje me paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesës, duke përcaktuar edhe institucionet përgjegjëse për trajtimin e saj. Kërkesa për fitimin e shtetësisë shqiptare paraqitet pranë strukturave vendore përgjegjëse të Policisë së Shtetit të vendbanimit të personit. Në rast se personi banon jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kërkesa paraqitet pranë misionit diplomatik, apo postit konsullor. Pas paraqitjes së kërkesës struktura vendore e Policisë së Shtetit, kryen verifikimet e nevojshme për vlerësimin e cenimit të sigurisë publike dhe brenda një afati 2 mujor nga paraqitja e kërkesës, e dërgon kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues pranë strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Brendshme. Ministria e Brendshme brenda 9 muajve shqyrtton dhe verifikon dokumentacionin e paraqitur, me qëllim verifikimin e plotësimin të kushteve të përcaktuara në këtë ligj dhe i propozon Presidentit të Republikës nxjerrjen e dekretit, shoqëruar nga dokumentacioni shoqërues. Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, Ministria e Brendshme brenda 45 ditëve ia kthen strukturave dhe institucioneve të përcaktuara, të cilat njoftojnë personin e interesuar brenda një afati 15 ditor. Presidenti i Republikës, brenda 60 ditëve nga paraqitja e propozimit nga Ministria e Brendshme, nxjerr dekretin përkatës dhe ia komunikon personit që ka paraqitur kërkesën. Në rast se kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk janë të plotë, i kthehen për plotësim strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Brendshme, brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes.

dhe ruajtur lidhje gjuhësore, kulturore dhe të traditës me Shqipërinë. Nga ky ndryshim pritet të përfitojnë edhe shtetasit kosovarë, të cilët ishin përjashtuar nga këto kriterë lehtësues nëpërmjet vendimit të Këshillit Ministrave.

TË HUAJT
Një tjetër mënyrë për fitimin e shtetësisë shqiptare do jetë edhe ajo nëpërmjet natyralizimit. Në nenin 7, të projektligjit, janë parashikuar kushtet që duhet të plotësohen nga shtetasi i huaj për fitimin e shtetësisë shqiptare. Më konkretisht një i huaj mund të marrë shtetësinë shqiptare nëse qëndron në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazh-

dueshme për jo më pak se 5 vjet, në territorin e Republikës së Shqipërisë, ka banesë, disponon të ardhura dhe burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për jetesën dhe kur zotëron njohuri të gjuhës shqipe, të folur dhe të shkruar, të certifikuar nga institucioni përkatës arsimor publik, si dhe njohuritë bazë të historisë dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas rregullave të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin. Ndërkohë që nga kjo përjashtohen refugjatët. Sipas ligjit ata mund të fitojnë shtetësinë vetëm pas 10 vitesh qëndrimi në Shqipëri.

Shoqëria përparimtare JUSTITIA
Shoqëria përparimtare JUSTITIA sh.pall ankastrin, faza e tretë, për shënjën e pasurisë së paluajtshme, për të cilat ka vlerë historike NBS Bank/ABI BANK, me këto të dhëna:
Lloji njësi me sip. 189 m2 nr.pasurisë 5/188/nd-1, zk.8350 vol 28 fq.146 RR.P.MYZEQARI TIRANË në pronësi të z.Arjan Rahmi BAHOLLIT. Çmimi me të cilin fillon shija në ankand është 161784 (njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e shtatëdhjetë e tetëdhjetë e katër) EUR.
-Lloji apartamenti sip.132m2 zk.8350 nr.pas.5/188/nd-1-19 vol 28 fq.185 Rruga Prokop Myzeqari TIRANË në pronësi të z.Arjan Rahmi BAHOLLIT.
Çmimi me të cilin fillon shija në ankand është 66.528 (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e njëzetë e tetë) EUR. Secili ofertues që do të marrë pjesë në ankand duhet të depozitojë si garanci shumën prej 10% të çmimit fillestar, në llogarinë e Shoqërisë Përparimtare Justitia që është pranë Bankës "BKT Bank" sh.p.a me numër IBAN:AL350551102144410521.PRCPJALLA.
Ankandi zhvillohet në datën 12.02.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbarsës gjyqësor, me adresë Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +35542278890

"Elton Kelmendi s'ka konflikte me persona të tjerë"

Grabitja me armë e biznesmenit në Shkozë, policia: Autorët, pjesë e një bande profesioniste

DURRËS - Biznesmeni 37-vjeçar Elton Kelmendi, i cili të shtunën u sulmua të shtunën që shkoi nga 3 personat e maskuar e të armatosur nuk ka rezultuar të ketë konflikte personale me persona të tjerë. Policia e Durrësit shpresonte se mund të gjente prova nëpërmjet qelizave të celularëve të biznesmenit dhe të bashkëshortes së tij. Autorët nga këqyrja e vendit të ngjarjes rezultojnë grabitës profesionistë, pasi nuk kanë lënë asnjë gjurmë për identifikimin e tyre. Burime nga grupi hetimor

bënë me dije se grabitësit fillimisht kishin marrë celularët e të zotëve të shtëpisë i kishin fikur dhe vetëm të nesërmen celularët janë gjetur të hedhur në disa rraqe të shtëpisë. Hetuesit shpresonin që nga telefonat të gjenin edhe itinerarin që kishin kryer për t'u larguar tre grabitësit profesionistë nga banesa Elton Kelmendit. "Autorët nuk kanë lënë asnjë shenjë a gjurmë. Dyshojmë që kemi të bëjmë me një bandë të mirëfilltë. Dyshimet janë që mund të jenë ndihmuar nga persona afër biznesmenit për të qenë aq koncizë në veprimet

e tyre. Tre grabitësit kanë lidhur bashkëshortët, ndërsa njëri prej autorëve ka nxjerrë jashtë shtëpisë djalin 7-vjeçar. Biznesmeni i kërcënuar në jetën e djalit të vetëm nuk ka bërë rezistencë, por iu ka treguar paratë që mbante në shtëpi të ruajtura në xhepin e një xhupi. Ata kanë marrë 10.800 euro, pasi kishin dhunuar fizikisht biznesmenin. Djalin e kanë lënë në oborrin e jashtëm të banesës", pohuan burimet e mësipërme. Po sipas bluve, "dyshohet që autorët të jenë kontingjent i botës së krimt, ish-të dënuar për grabitje me



Elton Kelmendi

GRABITJA

Mbrëmjen e 12 nëntorit u sulmua me armë dhe u grabit familja e biznesmenit të transportit ndërkombëtar, Elton Kelmendi. Ngjarja e rëndë ndodhi në lagjen 14 të qytetit bregdetar, në Shkozë. Pas ngjarjes së rëndë, policia nisi hetimet, ndërsa deri tani janë shoqëruar dhe marrë në pyetje 8 persona.

dhunë, nisur nga veprimet precize të neutralizimit të familjes dhe të grabitjes së parave. Mund të jenë edhe nga qytete të tjera të vendit dhe të jenë ndihmuar nga persona të tjerë në Durrës që kanë dënuar për aktivitetin e

biznesmenit dhe të parave që ai kishte në banesë. Nuk mund të arrijmë njëri dhe njëri nga këto. Nëse nuk gjejmë prova, kapuçet, maskat, armët si prova të pakundërshtueshme nuk arrijmë dot asnjë".

Gjendet një makinë e djegur te stacioni i trenit. Dyshohet për vrasës me pagesë

Atentat në Vlorë, plagoset me 2 plumba në trup bashkëpunëtori i Llanajve

41-vjeçari Mikel Mehmeti u qëllua në makinë nga 2 persona që lëviznin me motor

VLORE
Një 41-vjeçar ka mbetur i plagosur rëndë në një atentat të ndodhur mbrëmë në Vlorë. Mësohet se dy persona me motor i kanë prerë rrugën dhe kanë qëlluar me armë zjarri në drejtim të një automjeti tip "Audi A3" dhe me targa "AA 653 VC", me të cilën po udhëtonte Mikel Mehmeti nga Selenica. Për pasojë ky i fundit ka marrë një plumb në gjoks dhe një në bark dhe ndodhet në spital në gjendje kritike për jetën. Burime zyrtare nga policia e Vlorës bëjnë me dije se ngjarja ka ndodhur rreth orës 17:40 në rrugën "Gjergj Araniti", në lagjen "Pavarësia" të këtij qyteti. Menjëherë pas sinjalizimit për atentatin, policia ka shkuar në vendngjarje dhe ka nisur hetimet për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të krimt. Ndërsa, 41-vjeçari është dërguar në spitalin rajonal të Vlorës. Bluzat e bardha të këtij spitali pohuan se i plagosuri është futur direkt në sallën e operacionit ku i është nënshtruar një ndërhyrje kirurgjikale. Pak minuta pas atentatit, në afërsi të stacionit të trenit në Vlorë (lagje informale dhe e pa ndriçuar) është gjetur një automjet i djegur. Bëhet fjalë për një makinë tip "Mitsubishi" që dyshohet se është përdorur nga dy atentatorët për t'u larguar nga vendi i ngjarjes. Mendohet se autorët, pasi kanë përdorur motorin për atentatin, më pas kanë përdorur këtë automjet duke u zhdukur me shpejtësi në lagjen pranë stacionit të trenit. Ndërkaq, pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake, burime policore pohuan se ka qenë një atentat i mirëorganizuar dhe se në vendin e ngjarjes janë gjetur 10 gëzhoja, 5 nga të cilat kanë prekur makinën me të cilën po udhëtonte Mikel Mehmeti. Ndërkaq, burime jo zyrtare u shprehën se në atentat ka mbetur i plagosur edhe një



Vendi ku ndodhi atentati



Makina e djegur që u gjet te stacioni i trenit në Vlorë

person tjetër që po udhëtonte së bashku me Mikel Mehmetin me makinën tip "Audi", por nuk dihet gjendja shëndetësore e tij pasi nuk është paraqitur në spital. Burimet e mësipërme thanë se dyshohet që shënjestër e atentatit ishte 41-vjeçari Mehmeti. Gjithashtu, dyshohet se autorët janë vrasës me pagesë dhe e kanë ndërmarrë aktin në një orar me shumë lëvizje dhe në një rrugë ku ka qarkullim të madh automjetesh, pavarësisht se është një rrugë lagjeje. Nuk dihet ende motivi i kësaj ngjarjeje, ndërsa mësohet se Mikel Mehmeti është bashkëpunëtor i vëllazërve Llanaj në Vlorë. Llanajt njihen për masakrën e Çolës, ku pas një shërri në kazino në prill të vitit 2015, u vranë 3 të rinj. Për zbardhjen e motivit të kësaj ngjarjeje, po hetohet dhe e kaluara e Mikel Mehmeti në Greqi.

GJIROKASTËR - Spartak Çoçoli, me detyrë prokuror në prokurorinë e Gjirokastrës është shoqëruar dje në sallën e gjyqit për mitmarrje. Mësohet se Çoçoli fillimisht është mbajtur në ambientet e Drejtorisë së Policisë Gjirokastrë për të dhënë sqarime, ndërsa më pas është nisur drejt Tiranës. Ai po hetohet nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, pasi dyshohet të jetë përfshirë në një rast korrupsioni dhe ka marrë rryshfet për një çështje gjyqësore. Ai ka qenë nën përgjim nga prokurorët e Krimeve të Rënda për një periudhë të gjatë kohore. Para disa muajsh, prokurori Spartak Çoçoli u akuzua nga prindërit e

Krimet e Rënda: Po e hetojmë për korrupsion

U akuzua për mitmarrje, shoqërohet prokurori i Gjirokastrës, Spartak Çoçoli



një 17-vjeçareje se kishte marrë 1 mijë euro për të zgjidhur çështjen e rrëmbimit të vajzës së tyre. Nëna e vajzës, përveç rryshfetit, e

akuzua nga nënet 319 dhe 319/ç. Prokuroria për Krime të Rënda nuk ka kërkuar asnjë masë sigurimi personale në Gjykatën e Krimeve të Rënda për prokurorin Spartak Çoçoli. Po ashtu dhe policia nuk ka proceduar me arrest në flagrancë. Pra, nuk ka as urdhër ndalimi nga prokuroria dhe as vendim gjykatë për arrestim dhe as arrest flagrancë nga policia. Prokuroria për Krime të Rënda po kryhen veprime hetimore lidhur me këtë procedim".

SHKURT

Vjedhja e armëve, gjykata lë në burg 4 ushtarakët

VLORE - Gjykata e Vlorës ka dhënë dje masën e sigurisë "arrest me burg" për katër personat e arrestuar si përgjegjës të vjedhjes së armëve në bazën ushtarake në Pashalimanit. Bëhet fjalë për 52-vjeçarin Lesko Ramosaçaj, 42-vjeçarin Edlir Nelaçaj, 23-vjeçarin Ervis Memsulaj dhe 25-vjeçarin Ardit Ramaj. Ushtarakët akuzohen për shpërdorim detyre. Avokatët mbrojtës kanë kërkuar gjatë seancës një masë sigurie më të lehtë për të katër të arrestuarit, detyrim paraqitjeje. Për avokatët mbrojtës, depoja e armatimeve nuk ka as kushtet më minimale të sigurisë. Sipas tyre në vendin e qëndrimit të rojës mungon ndriçimi, por edhe kamerat e sigurisë prej kohësh. Pak ditë më parë në bazën ushtarake të Pashalimanit u voddhën tre armë zjarri, 40 granata dore, 40 ndezës dhe mbi 5 mijë fishekë.

Të shtëna me armë zjarri, thyhen xhamat e lokalit

FIER - Të shtëna me armë zjarri janë dëgjuar mbrëmjen e së dielës në një lokal Fier. Ngjarja në fjalë është regjistruar rreth orës 23:30 në një lokal në lagjen "Kastrioti", përballë Drejtorisë Rajonale të Tatimit Taksave. Mësohet se në kohën kur ndodhi ngjarja, lokali ka qenë i mbyllur. Ndërkohë, thuhet se nga plumbat janë thyer xhamat e lokalit. Ka qenë pronari i biznesit që ka njoftuar policinë për ngjarjen. Gjithashtu, mësohet se në vendin e ngjarjes nuk është gjetur asnjë gëzhojë, pavarësisht se është raportuar se ka pasur breshëri plumbash. Aktualisht policia po heton për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarjeje. Blutë kanë shoqëruar disa persona për t'i marrë në pyetje, mes tyre edhe pronarin e lokalit, së bashku me stafin. Paraprakisht dyshohet se të shtënat janë kërcënim ndaj pronarit të këtij lokalit.

Shkak i ngjarjes, ndarja e autorit me vajzën e viktimave. Fqinjët: Jemi tronditur!

TIRANË

Krimi brenda familjes trondit Tiranën. Një vrasje e trefishtë u shënua mëngjesin e djeshëm në zonën e Unazës së Re, në rrugë "Kristaq Mone". Pas një konflikti, dhëndri ka ekzekutuar me armë zjarri në banesën e tyre vjehrrin dhe vjehrrën dhe më pas veten. Burime zyrtare nga policia e kryeqytetit bënë me dije se autori i këtij krimi makabër ishte Majlind Lila me origjinë nga Burreli. Krismat e armëve kana alarmuar fqinjët, të cilët kanë lajmëruar uniformat blu. Menjëherë policia ka shkuar në vendngjarje, ku ka gjetur trupat e pajetë të 63-vjeçarit Bujar Mata dhe bashkëshortes së tij 42-vjeçare, Valentina Mata me origjinë nga Pogradeci. Si pas hetuesve të çështjes, autori i vrasjes së çiftit Mata, pas krimit ka vetëplagosur veten me thikë dhe më pas është hedhur nga ballkoni i katit të dytë mbi kangjella. Ai është dërguar në gjendje të rëndë në Spitalin e Traumës, ku dhe ka ndëruar jetë. "Sot rreth orës 06:56, në 'Astir', në rrugën 'Kristaq Mone' janë gjetur në banesë të vrasës me armë zjarri shtetasit B.M., 63 vjeç dhe Xh.M., 42 vjeçe. Posh-të ballkonit të banesës së shtetasve B.M., dhe Xh.M. është gjetur i dëmtuar dhëndëri i tyre, shtetasi M.L., i cili është transportuar për ndihmë mjekësore në spital ku dhe ka ndëruar jetë. Po punohet për

Krimi në familje trondit Tiranën, dhëndri vret vjehrrin e vjehrrën dhe më pas veten

42-vjeçari u kthye nga Suedia para 3 ditësh. Pas vrasjes, u vetëplagos me thikë dhe u hodh nga ballkoni mbi kangjella



Vendi ku ndodhi vrasja e trefishtë



sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes", thuhej në njoftimin zyrtar të policisë së Tiranës. Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake, rezultojn se autori i krimit të

trefishtë kishte vetëm tri ditë që ishte kthyer nga Suedia ku kishte bashkëjetuar me Nevilën, vajzën e dy viktimave. Ndërkohë, mësohet se ngjarja ka marrë shkas pas ndarjes

së 42-vjeçarit me të bijën e çiftit Mata, me të cilën kishte dhe një fëmijë (vajzë të vogël).

VRASJA E TREFISHTË

Burime nga policia pohuan se para tri ditësh, Majlind Lila ishte kthyer nga Suedia dhe kishte qëndruar në një hotel në Tiranë. 52-vjeçari ishte kthyer në Shqipëri, pasi ishte ndarë nga gruaja e tij 36-vjeçare, me të cilën kishte bashkëjetuar prej disa kohësh në Suedi. Mësohet se Lila kishte pasur konflikte me ish-bashkëshorten dhe ishte kthyer në Tiranë pa familjen.

Mëngjesin e djeshëm, ai ka shkuar te banesa e prindërve të kësaj të fundit dhe në debat e sipër i ka qëlluar për vdekje. Mësohet se Majlind Lila konsumonte shpesh pije alkoolike dhe dyshohet që edhe në momentin e krimit të ketë qenë në gjendje të dehur. Gjatë këqyrjes paraprake të vendit të ngjarjes, policia ka gjetur tri gëzoja, 63-vjeçari Bujar Mata u gjet i vrarë në dhomën e ndenjes, ndërsa bashkëshortja e tij u gjet në korridorin e shtëpisë në përpjekje për t'ju larguar vrasësit. Mësohet se shkak i

konfliktit ka qenë ndarja e Majlind Lilës me vajzën e çiftit Mata, që solli edhe vrasjen e trefishtë. Kanë qenë fillimisht fqinjët që kanë dëgjuar krismat dhe më pas kanë njoftuar policinë. "Ishte ora 6 e 10 kur dëgjuam të shtënat, jemi të tronditur. Ishin njerëz shumë të mirë. Autorin nuk e njihnim, nuk kemi dijeni për ndonjë konflikt", tha dje njëri prej fqinjëve të çiftit Mata. Ndërsa, një tjetër fqinj pohoi: "Jemi tronditur shumë nga ajo që ndodhi. Bashkëshortët Mata ishin shumë të mirë, pasi i njohim prej më shumë se dy dekadash". Ngjarja e rëndë po hetohet nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, e cila ka marrë dëshmitë e të afërmeve të viktimave si dhe ka sekuestruar kamerat e hotelit ku qëndroi autori i ngjarjes. Ky është rasti i dytë i krimit në familje në muajin e parë të këtij viti. Më 2 janar, në qytetin e Ballshit, 34-vjeçari Gazmend Musta vrau me thikë në banesë bashkëshorten 31-vjeçare, Gentiana Çauahaj dhe kumatën e tij 18-vjeçare, Merisa Çauahaj, pasi kërkoi që të shkonte tek prindërit e saj për festat.



Implemented by giz

OPEN CALL FOR TENDER PREQUALIFICATION

1. GENERAL CONDITIONS

- 1.1. **Requester:** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ), Office Tirana, Rr. Skenderbej, No. 21/1
- 1.2. **Profile:** German Development Cooperation, Office in Tirana supports Albania on its path to European integration and development through projects implemented in: Economic development, Economic legal reform, Vocational education and training, Reform of the water sector, Rural development, and some other areas
- 1.3. **Subject:** The GIZ Office Tirana invites qualified furniture companies to express their interest in providing the below supply and services:
Office Desk (L-shaped)
Office Desk (160x80x72)
Movable Drawer Locker Unit
Meeting Table
Office etagere
Small Meeting Table (square)
Book Shelves
Swivel Chairs
Regular Fixed Chairs
Stand for working stations division

2. Companies should fulfill the following requirements:

- 2.1 The products must be certified according to European standards.
- 2.2 The company should be an authorized service provider for the products it will offer
- 2.3 Have implemented similar projects in the past.
- 2.4 Provide evidences of brand certified professionals, who will implement the solution.
- 2.5 The bidders must provide actual technical brochures of the types and models and specifications of the furniture offered.
- 2.5 Professional services: To implement successfully all the above-mentioned equipment's and to integrate them accordingly it will be necessary that the bidder be able to quote the necessary services. Therefore, it is needed to quote the following services:

- Site survey and planning (scheduling)
- Mounting equipment
- Testing the deployment
- Installation report

All legal entities interested in application process should ask for [an application form](#) to the address: giz-albanien@giz.de

3 The **due date** for submitting the application is **24 January 2019**. The documents should be submitted in a sealed envelope, marked "Application for prequalification: Furniture and Equipment", addressed to:

German Development Cooperation Office (GIZ), Office in Tirana, Rr. Skenderbej, No. 21/1

After the due date for submitting the application, the process of prequalification will follow. The submitted applications will be evaluated, and only prequalified candidates will be invited to answer to the bid.

Afatet e hetimit drejt skadimit, brenda 2 javësh merret vendimi

Greçia përgjigjet për Klement Balilin, vijjnë provat e reja për "Eskobarin e Ballkanit"

TIRANË - Prej dy vitesh, Klement Balili vazhdon ta kthejë duarbosh policinë gjatë aksioneve të dështuara për arrestimin e tij, megjithatë javët e ardhshme sfida e radhës nuk do të jetë për uniformat blu, por për prokurorinë. Siç bën me dije një burim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Greçia i është përgjigjur në fund të muajit dhjetor 2018, përmes një letërporosie, kërkesës së Kriemeve të Rënda, e cila këmbënguli t'i dorëzoheshin prova shtesë ndaj 46-vjeçarit. Kjo letërporosi ishte justifikimi kryesor i prokurorisë që në 2018-ën zgjati 3 herë afatin hetimor për Balilin, i etiketuar ndryshe si "Eskobarin e Ballkanit", por që për shkak të dështimit të policisë për ta arrestuar, u quajt nga ish-ambasadori Donald Lu edhe si magjistari. Tashmë që pala



greke i bashkëngjiti akte të reja, mes tyre procesverbale të këqyrjes së ngarkesës së hashashit dhe dëshmitë e dy të dyshuarve si skafistë, Petro Dalanaj dhe Kleanth Palaj, sfida për prokurorinë është se sa kohë do t'i duhet asaj për t'i mbyllur hetimet. Ndonëse nuk jepen detaje nëse kanë apo jo vlerë për hetimet procesverbale të dorëzuara, një burim tha se pritet që brenda muajit janar prokuroria t'i dorëzojë

gjykatës dosjen e mbyllur, duke dërguar nën akuzë vetëm Klement Balilin, njeriun që përmbi dy vjet vazhdon në arrati të luajë me autoritetet. Pas dorëzimit të dosjes është gjykatë që do të vlerësojë në një seancë paraprake për dërgimin në gjykatë të Balilit për veprat e trafikut dhe të grupit kriminal. Ajo që dihet me siguri është se që prej 2016-ës policia ka organizuar 14 aksione për kapjen e tij, por ka dështuar, madje edhe pse vendosi një shpërblym prej 5 milionë lekësh për çdokënd që do të jepte informacion të vlefshëm. Ky dështim u lakua edhe nga kryeministri Edi Rama gjatë një takimi me drejtuesit e policisë. "Unë nuk dua të presim të vijë ambasadorja amerikane për të na kujtuar gjatë ndonjë falimi përsëritës që Klement Balili nuk është kapur akoma", thoshte Rama. "Top Channel"

INVESTIGIMI ZERI I AMERIKES

Përgjimi i ish-drejtorit të Burgjeve, Arben Çuko zbulon ndërhyrjet për punësime në administratë

Farsa e konkurseve, shefja e kabinetit të Ramës ndërhyr për emërimet në Burgje

"Fola me zonjën Bizhga, i thashë që u fut Vitjona në punë"




Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Aleksandra Bogdani,
BIRN, VOA

Më 30 prill 2018, drejtori i Përgjithshëm në atë kohë i Burgjeve, Arben Çuko mori një telefonatë nga kabinetin e kryeministrit Edi Rama. Biseda bëhej me porositi të drejtoreshës së kabinetit, Vali Bizhga dhe kishte në fokus punësimin e një vajze. Çuko, i cili ndodhej nën përgjim nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, pohon në bisedë se e kishte firmosur punësimin më herët atë ditë. "Fola me zonjën Bizhga para gjysmë orë dhe i thashë se u fut Vitjona në punë", citohej të pohojë ai në transkriptin e zbardhur.

Të dhënat e siguruar përmes një duzine përgjimesh dhe mesazhesh të shkëmbyera tregojnë se telefonata të ngjashme mbi punësimet apo transferimet e punonjësve në sistemin e burgjeve ishin pjesë e rutinës së përditshme të punës së ish-drejtorit, Arben Çuko. Zyrtarë lokalë, deputetë të Partisë Socialiste dhe të zgjedhur vendorë janë përgjuar ndërsa shkëmbejnë trafik influencë dhe kërkoniin fave për punësime apo transferime nisur nga lidhjet partiake apo personale dhe jo mbi bazën e meritës. Përgjimet ekspozojnë gjithashtu se si një konkurs për rekrutime masive në policinë e Burgjeve u kthye në një fushatë punësimi për militantët socialistë apo njerëzit e lidhur me pushtetin - një fenomen ky i përhapur në administratën publike në Shqipëri.

Arben Çuko, një ish-komandant i Gardës së Republikës dhe ish-deputet i Partisë Socialiste u ngjiti në krye të Burgjeve në korrik të vitit 2017, por vetëm disa muaj më pas u përfishi në hetimet e Prokurorisë, për shkak të komunikimeve të tij telefonike me anëtarët e një grupi kriminal për transferimin e një të dënuari. Ai u shkarkua nga detyra pa mbushur ende vitin dhe në



Faksimile nga përgjimi i ish-drejtorit të Burgjeve, Arben Çuko

tetor 2018 u arrestua për korrupsion nga Prokuroria e Krimeve të Rënda. Çuko i ka mohuar akuzat dhe ndodhet aktualisht në arrest shtëpie. Prokuroria e Krimeve të Rënda konfirmoi se procedurat e punësimeve në

Burgje janë në proces hetimi. Një drejtues i çështjes së rezervuar megjithatë të komentonte nëse ishin marrë në pyetje persona të dyshuar për ushtrim ndikimi të paligjshëm. Drejtoresha e kabinetit të kryeministrit, Vali Bizhga pranoi bisedën

PERGJIMI: KONKURS GJASME

"Do bëjmë dhe procedurën gjase fitoi kjo, humbën këta të tjerët. Më kanë ardhur 217 veta, gjase me konkursin e famshëm 'publik', thotë ai.

telefonike gjatë një interviste, ndërsa shpjegoi se kishte ndërmjetësuar për rastin pas një kërkesë për ndihmë nga motrat e Nënë Terezës. Thëniet e saj u konfirmuan edhe nga Motër Tereza Maria e misionit me qendër në Tiranë, e cila pohoi se i kishte transmetuar Bizhگز një kërkesë për ndihmë gjatë një takimi në Kryeministri, të cilin e quajti privat. Zyra e shtypit e Kryeministrit nuk iu përgjigj një kërkesë për koment mbi ndërhyrjet për punësime në burgje deri në botimin e këtij shkrimi.

NDËRHYRJET E PALIGJSHME

Ndara e vendeve të punës në administratë sipas përkatësisë partiake dhe jo sipas meritës është një problem i mbartur i tranzicionit në Shqipëri. Reforma në administratën publike është gjithashtu një ndër kushtet kryesore për integritet në BE, e cila në progresraportin e fundit kërkoi hapa të mëtejshëm në sigurimin e një administrate efektive, të depolitizuar dhe profesionale. Administrata jopolitike është gjithashtu një premtim i përsëritur i kryeministrit Edi Rama, i cili gjatë fushatës elektorale të vitit 2017 fajësoi aleatin e vogël LSI për punësime politike dhe deklaroi se do ta çonte "tëpsinë për skrap". Të dhënat e siguruar përmes

bisedave dhe mesazheve të përgjuara të Çukos tregojnë se mbajtja e këtij premtimi minohet gjerësisht nga një sistem i ngritur mbi bazën e shpërbërimeve partiake si dhe nga ndërhyrjet e zyrtarëve të të gjitha niveleve. Përveç zyrës së shefes së kabinetit të kryeministrit Edi Rama, në përgjimet e Prokurorisë së Krimeve të Rënda dalin kreu i Komisionit të Ligjeve, Ulis Komisa dhe deputetë socialistë Klodiana Spahiu, Blerina Gjylameti dhe Paulin Sterkaj. Trafik influencë për punësime apo transferime rezultojnë të kenë ushtruar gjithashtu zyrtarë lokalë, punonjës të administratës apo të zgjedhur vendorë. E pyetur mbi rrethanat e telefonatës së bërë në emër të saj me Çukon, shefja e kabinetit të Ramës, znj. Vali Bizhga shpjegoi se kishte marrë një kërkesë për ndihmë nga motrat e Nënë Terezës gjatë një takimi të zhvilluar me të në Kryeministri në fund të janarit. Gjatë takimit, motrat e Nënë Terezës kishin kërkuar ndihmë për një grup prej rreth 15 të rinjsh të sapodiplomuar nga familjet vulnerabelë, të cilët e kishin pasur të pamundur të gjenin punë. Bizhga shtoi se ishte ndërjer keq gjatë takimit dhe CV-të e të rinjve ia kishte përcjellë Shërbimit Kombëtar të Punësimit. E pranishme në takim ishte edhe Vitona Dervishaj, një vajzë rreth të 30-ave e diplo-

bur jetën në aksident. Gjatë ceremonisë mortore, shokët e të atit i kishin premtuar asaj vendin e tij në burgun e Pushë-Krujës", tha znj. Bizhga. Ajo shtoi se nga janari në fund të prillit ishte pritur që të krijohet mundësia për konkurs dhe se telefonata nga zyra e saj ishte bërë pa insisitimit të vazhdueshëm të motrave të Nënë Terezës. "Ajo nuk është pranuar në punë pa konkurs dhe zotit Çuko nuk i është thënë që do ta fusësh në punë. Është e vërtetë që ajo është akcesuar në konkurs, por ftesa për konkurs u drejtohet të gjithëve", tha Bizhga. E pyetur nëse ajo ia kishte dalë të fitonte konkursin, Bizhga

PERGJIMET

Të dhënat e siguruar përmes një duzine përgjimesh dhe mesazhesh të shkëmbyera tregojnë se telefonata të ngjashme mbi punësimet apo transferimet e punonjësve në sistemin e burgjeve ishin pjesë e rutinës së përditshme të punës së ish-drejtorit, Arben Çuko.

muar për juridik, e cila ishte e vetmja që insistonte për punë në shtet. "Arsyeja lidhej me babanë e saj, i cili kishte qenë punonjës i Burgjeve dhe kishte hum-

ta se nuk e kishte ndjekur çështjen në detaje. "Unë nuk di të them nëse kishte një kandidat më të zotin se Vitjona për atë punë. Këtë unë nuk di ta them", sh-



Ish-deputeti i PS u arrestua për korrupsion, aktualisht në arrest shtëpie


Arben Çuko: Pres t'më thonë liroi sipas listave që ka sjellë partia

"217 veta erdhën në konkursin e famshëm gjasje publik"

sa është e mundur. Pastaj është çështje e institucioneve nëse veprojnë ose jo", tha zoti Sterkaj, duke shtuar se punonjësia në fjalë ishte edhe "e djathtë". "Unë shqetësohem për hallet e njerëzve sa herë shoh padrejtësi, pa pyetur nëse janë të majtë ose të djathtë. Ne kaq kemi në dorë, se të tjerat i ka kryeministri", shtoi më tej Sterkaj. Deputetja Gjylameti tha se nuk komentonte "çështje që janë në hetim nga prokuroria". Njësoj u përgjigj edhe kreu i Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja. "Nuk mund të komentoj të dhëna të dala nga një hetim penal në proces, që përbën sekret hetimor për sa kohë nuk janë shprehur organet kompetente", tha Manja.

FARSA E KONKURSEVE

Sistemi i burgjeve në Shqipëri përbëhet nga 23 institucione të vuajtjes së dënimit dhe numëron një numër të konsiderueshëm punonjësish, si në radhët e policisë, ashtu edhe në administratë. Për të dyja kategoritë, procedurat e rekrutimeve kryhen përmes konkurseve publike. Megjithatë, një konkurs publik për rekrutime masive në policinë e Burgjeve u kthye në një fushatë punësimi për militantët e Partisë Socialiste dhe njerëzit e lidhur me pushtetin. Konkursi publik për policë të rolit bazë u shpall në fund të marsit të kaluar dhe synonte të rekrutonte mbi 250 punonjës për 17 institucione të vuajtjes së dënimit në Shqipëri. Testimi u krye më 3 prill dhe thirrjes u përgjigjën mbi 1300 kandidatë. Por përtej fasadës,



Faksimile nga përgjimi i ish-drejtorit të Burgjeve, Arben Çuko

PROBLEMET

Ndarja e vendeve të punës në administratë sipas përkatësisë partiake dhe jo sipas meritës është një problem i mbartur i tranzicionit në Shqipëri. Reforma në administratën publike është gjithashtu një ndër kushtet kryesore për integrim në BE

to i ajo. E kontaktuar përmes telefonit, motër Tereza Maria e misionit të Motrave të Nënë Terezës në Tiranë konfirmoi takimin në kryeministri dhe tha se kishte shkuar atje në mirëbesim, për të qarë një hall. "Takimi ka qenë privat dhe unë kam kërkuar ndihmë për një grup të rinjsh që nuk kishin asnjë mundësi punësimi. E vetmja për të cilën u bë dicka ishte Vitiona, por edhe ajo nuk u rregullua në profilin e saj, por si arkiviste", tha motër Tereza Maria. "Të tjerët i lanë nëpër zyrat e punës, derisa e kuptuan se janë tallur te zyrat e punës dhe janë tërhequr", shtoi e zhgënjyer ajo. Komunikimet e përgjuara nga Prokuroria e Krimeve të Rënda tregojnë se deputeti socialist, Ulsi Manja i kërkonte Çukos transferimin e një punonjësi të policisë së burgjeve nga Kruja në Tiranë dhe një çështje të ngjashme diskuton edhe deputetja e Durrësit, Klodiana Spahiu.

Blerina Gjylameti përmendet në një bisedë të Çukos me një person të tretë për ndërhyrjen në punësimin e një personi të lidhur me Partinë Socialiste, ndërsa Paulin Sterkaj ankohet për transferimin e një policeje me origjinë nga Tropoja, nga burgu 313 te "Ali Demi". Zonja Spahiu, deputete e qytetit të Durrësit shpjegoi se e kishte telefonuar Çukon për një rast, që sipas saj ishte transferuar politikisht nga Durrësi. "Ai ishte me prindër të sëmurë dhe punonte shumë larg banesës së tij. Ai kërkonte të drejtën e tij, pasi ishte transferuar vetëm për shkak të bindjeve të majta", tha Spahiu, duke shtuar se nuk është e sigurt nëse transferimi u bë. Edhe zoti Sterkaj pohoi se i ishte drejtuar Çukos për t'i përcjellë një ankesë mbi transferimin e padrejtë të një punonjëseje të policisë së burgjeve. "Sa herë marr ndonjë ankesë, unë reagoj

KATEGORITË

Sistemi i burgjeve në Shqipëri përbëhet nga 23 institucione të vuajtjes së dënimit dhe numëron një numër të konsiderueshëm punonjësish, si në radhët e policisë, ashtu edhe në administratë. Për të dyja kategoritë, procedurat e rekrutimeve kryhen përmes konkurseve publike.

ish-drejtori Çuko ankohej në mesin e muajit prill se fituesit ishin bllokuar nga kryeministri dhe se të gjithë kandidatët u përkisnin listave të partisë. "O

Gerti, gjithçka është e bllokuar nga kryeministri dhe nuk e di kur do të zh-

bllokohej", thoshte Çuko më 14 prill. "Unë pres që nesër pasnesër të më thotë sa veta do fusësh nga 1 te 250. Unë s'e di ç'do të thotë ai tani", shtohet aty.

"Ki parasysh që Lushnja nuk ka asnjë vend bosh, Fieri ka 20 vende dhe kanë sjellë 200 veta. Testimi këtë herë u bë me 1358 veta dhe të gjithë ishin listat e partisë. E kishin të qartë ata, hajt se po i fusim në burgje", shprehet Çuko sipas transkriptit të bisedës. Përgjimet nxjerrin gjithashtu në pah manovrat e kryera me testimet, ku rezultatet manipulohen për të favorizuar kandidatët e servirur përmes kanaleve partiake. Në përgjigje të një kërkesë për të punësuar një person të lidhur me Partinë Socialiste, Çuko shpjegon se si do ta nxirrte atë fitues. "Do bëjmë dhe procedurën gjasje fitoi kjo, humbën këta të tjerët. Më kanë

ardhur 217 veta, gjasje me konkursin e famshëm publik", thotë ai.

Episodet e dosjes së zotit Çuko nuk janë të parat në sistemin e burgjeve dhe as në administratën publike në tërësi. Në qershor 2017, pak para zgjedhjeve të përgjithshme, Ministria e Drejtësisë denoncoi funksionarë të LSI-së në Shkodër për punësime fiktive në burgun ende të papërfunduar në atë kohë të Regit.

Ndërsa në mars të vitit 2018, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil i dorëzoi Kuvendit një raport, sipas së cilit 1/3 e punësimeve në administratë bëhen me urdhër titullari dhe jashtë procedurave të ligjit.

"Zëri i Amerikës"

PROTESTA E STUDENTËVE REAGIMET

Pedagogët: Dhuna ndaj të rinjve, kërkojmë reagim serioz nga instancat përgjegjëse

Studentët nuk tërhiqen, vazhdon ngujimi brenda godinave të fakulteteve "Kërkojmë rrëzimin e ligjit për arsimin e lartë"

Voltiza Duro

Qindra studentë të universiteteve publike në vend vazhdojnë të ngujuar brenda godinave të fakulteteve të tyre deri në plotësimin e kërkesave që ata i kanë parashtruar qeverisë. Ditën e djeshme edhe studentët nga universitetet e rretheve si ai i Elbasanit, Durrësit dhe Shkodrës i janë bashkuar protestës duke bojkotuar mësimin. Deri më tani të rinjtë theksojnë se nuk do të heqin dorë nga qëndresa deri në rrëzimin e ligjit për arsimin e lartë dhe tregojnë se po punojnë me grupe të tjera studentësh për të tërhequr në protestën e tyre. "Bojkoti i mësimit vazhdon dhe do të vazhdojë deri në rrëzimin e ligjit për arsimin e lartë. Ne nuk do të tërhiqemi. Aktualisht janë ngujuar brenda fakulteteve studentët e Ekonomikut, Drejtësisë, Arkitekturës, Inxhinierisë së Ndërtimit, Mjekësisë, dhe së fundi na janë bashkuar edhe ata të Politeknikut. Mesa kemi informacion edhe në universitetin Aleksandër Xhuvani në Shkodër nuk është zhvilluar mësim, e po ashtu edhe në Durrës e Elbasan. Studentët e bashkuar kanë për të fituar", thotë një prej studentëve të Ekonomikut për "Gazeta Shqiptare".

REAGIMI I SENATIT TË UT-SË

Senati Akademik i Universitetit të Tiranës ka reaguar në lidhje me protestën e studentëve dhe



kërkesat e tyre. Përmes një njoftimi për shtyp, Senati Akademik i UT-së thekson mbështetjen e tyre për studentët dhe kërkesat që ato kanë. Në të njëjtën kohë Senati garanton të drejtën e studentëve dhe personelit akademik për zhvillimin normal të mësimit. Po ashtu nënvizohet shtyrja e pagesës së tarifave shkollore si dhe shtyrjen e

plotësimin të dokumentacionit për përfitim të bursave.

REAGIMI I PEDAGOGËVE

Pas ndërhyrjes së policisë brenda auditorëve ku ndodhen studentët e ngujuar, ka reaguar edhe departamenti i Marketing-Turizëm në Fakultetin Ekonomik, Universitetit të Tiranës, lidhur me ngjarjet e fundit që dënon ndërhyrjen e forcave policore në ambientet universitare dhe aktet e dhunës së ushtruar ndaj studentëve; mbështet arsimin cilësor për të përmirësuar aktivitetin akademik dhe gjetjen e një platforme të përshtatshme të konsultuar nga stafet akademike. Kërkojmë një reagim serioz dhe të menjëhershëm të institucioneve përgjegjëse për dy pikat e lartpërmendura", thuhet në deklaratën e pedagogëve. "Gaztori nuk ka plan të ulë tarifat e masterit, të rrisë peshën e votës studentore, të ndalojë financimin publik të diplomoreve private, të rrisë buxhetin për arsimin, të rrisë ligjin e arsimit të lartë etj. I vetmi plan i tij është të gënjëjë dhe ndërsejë policinë. Senatorët e Universitetit të Tiranës kanë shpikur mënyrën se si të jkalohet parimi i të tretës së përjashtuar në një kontrakt. Këtë mbështesin kërkesat e studentëve, andej bëjnë thirrje për rifillimin e mësimin. Me sa duket nga njëri vesh i tërheq gaztori dhe nga tjetri studentët. Dhe në vend se t'u skuqet faja nga mosdënimi i dhunimit policor të universiteteve thjesht po u skuqen veshët", thotë pedagogu Qori.

departamenti kërkojnë reagim serioz dhe të menjëhershëm të institucioneve përkatëse. "Departamenti Marketing-Turizëm, Fakulteti Ekonomik, Universiteti të Tiranës, lidhur me ngjarjet e fundit dënon ndërhyrjen e forcave policore në ambientet universitare dhe aktet e dhunës së ushtruar ndaj studentëve; mbështet arsimin cilësor për të përmirësuar aktivitetin akademik dhe gjetjen e një platforme të përshtatshme të konsultuar nga stafet akademike. Kërkojmë një reagim serioz dhe të menjëhershëm të institucioneve përgjegjëse për dy pikat e lartpërmendura", thuhet në deklaratën e pedagogëve. "Gaztori nuk ka plan të ulë tarifat e masterit, të rrisë peshën e votës studentore, të ndalojë financimin publik të diplomoreve private, të rrisë buxhetin për arsimin, të rrisë ligjin e arsimit të lartë etj. I vetmi plan i tij është të gënjëjë dhe ndërsejë policinë. Senatorët e Universitetit të Tiranës kanë shpikur mënyrën se si të jkalohet parimi i të tretës së përjashtuar në një kontrakt. Këtë mbështesin kërkesat e studentëve, andej bëjnë thirrje për rifillimin e mësimin. Me sa duket nga njëri vesh i tërheq gaztori dhe nga tjetri studentët. Dhe në vend se t'u skuqet faja nga mosdënimi i dhunimit policor të universiteteve thjesht po u skuqen veshët", thotë pedagogu Qori.

Rama: të garantohet mësimi

I menjëhershëm ka qenë edhe reagimi i kryeministrit Edi Rama, i cili përmes një statusi në "Twitter" ka shprehur mbështetjen për Senatin Akademik të UT-së. Sipas Ramës, duhet t'i garantohet mësimi sa më shpejt shumicës së studentëve, ndërsa shton se kërkesat e tyre do të përmbushen sipas planit. "Përsëritës deklaratën e Senatit Akademik të UT. Uroj që t'i garantohet mësimi një orë e më parë shumicës që po pengohet brutalisht. Kërkesat do të përmbushen sipas planit të publikuar dhe po shkojmë shumë përtej tyre. Dialogu e bashkëpunimi me universitetet do thellohet", shkruan Rama

54 përfaqësues të ministrisë në fakultete për shpjegimin e VKM-ve

Ditën e djeshme zv.ministrja e Arsimit, Besa Shahini në një deklaratë për mediat ka thënë se në sekretariatë e fakulteteve do të ketë përfaqësues nga MASR për t'iu shpjeguar studentëve VKM-të e muajit dhjetor. "Dua t'ju njoftoj që nga sot (dje) nëpër sekretariatë e fakulteteve tuaja kemi dërguar 54 punonjës të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë që të qëndrojnë pranë jush, t'ju takojnë, t'ju japin gjithë informacionin e nevojshëm për zbatimin e vendimeve të ministrave që u morën në dhjetor dhe që prekin konkretisht çështjet e tarifave dhe bursave të studimeve tuaja. I kemi instruktuar që nga sot të asistojnë dhe qartësojnë zbatimin e vendimeve të ministrave që u morën në dhjetor dhe që prekin konkretisht çështjet e tarifave dhe bursave të studimeve tuaja. I kemi instruktuar që nga sot të asistojnë

BESA SHAHINI

Në sekretariatë e fakulteteve do të ketë përfaqësues nga MASR për t'iu shpjeguar studentëve VKM-të e muajit dhjetor. "Dua t'ju njoftoj që nga sot (dje) nëpër sekretariatë e fakulteteve tuaja kemi dërguar 54 punonjës të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë që të qëndrojnë pranë jush, t'ju takojnë, t'ju japin gjithë informacionin e nevojshëm për zbatimin e vendimeve të ministrave që u morën në dhjetor dhe që prekin konkretisht çështjet e tarifave dhe bursave të studimeve tuaja. I kemi instruktuar që nga sot të asistojnë dhe qartësojnë zbatimin e vendimeve të ministrave", theksoi Shahini.

dhe qartësojnë zbatimin e vendimeve të ministrave që u morën në dhjetor dhe që prekin konkretisht çështjet e tarifave dhe bursave të studimeve tuaja. I kemi instruktuar që nga sot të asistojnë

sional, që sivjet aplikohet tek të gjithë studentët pa marrë parasysh mesataren e notave; përjashtimi nga tarifa e studentëve me notën mesatare nga 9-10 në vit të parë apo në vitet tjera nëse

kanë mbyllur provimet e vitit paraprak, pra ekselentët; trajtimin me bursë dhe gjysmë bursë të studentëve ekselentë; përgjysmimin e tarifave të programeve të ciklit të dytë për ekselentët dhe studentët që vijnë nga familje nevojë ekonomike, me nevoja të veçanta, studentët nga komunitetet pakica kombëtare dhe të tjera kategori të përcaktuara në VKM 780. "Dua të qartësoj një gjë më shumë procedurale, por që është e rëndësishme, e adresoi dhe ministri Ahmetaj në paraqitjen e tij, aplikimi i VKM-ve me efekt tek studenti bëhet nga vetë universitetet. Pra, Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka



Zv.ministrja e Arsimit, Besa Shahini

ndarë fondin shtesë për të trajtuar të gjithë studentët por identifikimi i studentëve përfitues, përcaktimi i notave mesatare, identifikimi i studentëve në kategoritë e veçanta, këto janë funksione të universiteteve dhe kryhen

atje. Kjo është edhe arsyeja pse kemi dërguar njerëz atje e nuk i ftuam universitetet këtu. Rrjedhimisht, kjo sqaron edhe kohën që marrin VKM-të për t'u zbatuar në masë të ndjeshme për studentët", u shpreh zv.ministrja.

NËNSHTETËSIA GREKE APLIKIMI

Voltiza Duro

Emigrantët shqiptarë që kanë vite që punojnë edhe jetojnë në Greqi mund të përfitojnë nënshtetësinë greke. 'Gazeta Shqiptare' zbardh sot kategoritë e individëve që kanë të drejtë aplikimi si dhe ata që nuk mund të marrin nënshtetësi. Përkatësisht personat që nuk kanë leje qëndrimi ose kanë një leje qëndrimi të përkohshme nuk kanë të drejtë të aplikojnë për nënshtetësi helene. Gjithashtu, iu humb e drejta e aplikimit për këtë të fundit edhe individëve që kanë marrë dënime me burg që janë më shumë se 6 muaj, për lloje të caktuara krimesh, ose dënime që janë më shumë se 1 vit për krime që janë kryer me dashje.

APLIKIMI

Ndërkohë mund të aplikojnë për nënshtetësinë greke personat që kanë mbi 7 vite qëndrimi të përhershëm dhe të ligjshëm në Greqi si dhe ata që kanë mbi 3 vjet qëndrim të përhershëm dhe të ligjshëm në Greqi me kusht që të jenë martuar me një nënshtetas/e grek/e dhe të kenë fëmijë me të. Edhe individët që kanë më shumë se 3 vite qëndrim të përhershëm dhe të ligjshëm nëse kanë një fëmijë në moshë të mitur që ka nënshtetësi greke mund të marrin nënshtetësi. Përjashtohen nga aplikimi ata që e kanë fituar nënshtetësinë, sepse kanë frekuentuar një shkollë greke. Për nënshtetësinë helene mund të aplikojnë edhe refugjatët apo personat që janë pranuar si individë pa nënshtetësi nga autoritetet greke, me kusht që të kenë mbi 3 vite qëndrim të përhershëm në këtë shtet.

DOKUMENTACIONI

Kandidatët e interesuar për të marrë nënshtetësinë greke duhet të dorëzojnë një "deklaratë natyralizimi" pranë bashkisë së vendbanimit të tyre; një aplikim për natyralizim si dhe një leje qëndrimi. Respektivisht kjo e fundit mund të jetë: leje qëndrimi afatgjatë ose leje qëndrimi e brezit të dytë; leje për bashkëshortët/et e nënshtetasve grekë ose të BE-së, ose një prind i një nënshtetasi grek në moshë të mitur; leje për një refugjat politik ose me mbrojtje të përkohshme; si dhe leje qëndrimi e dhënë si person pa nënshtetësi. Gjithashtu, kandidatët duhet të dorëzojnë edhe pasaportën e tyre. Nëse individi ka lindur jashtë vendit nëvojitet një certifikatë lindjeje, e vërtetuar dhe e përkthyer në greqisht, ndërsa nëse ka lindur në Greqi, i duhet të paraqesin një certifikatë lindjeje greke.

Skualifikohen personat me leje qëndrimi të përkohshme dhe ata që janë në burg

Emigrantët në Greqi, kategoritë që mund të aplikojnë për nënshtetësinë helene

Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët



Është e domosdoshme që aplikantët të dorëzojnë edhe auditimet e taksave personale për vitet e fundit, numrin e sigurimeve shoqërore (?.?.?.?) si dhe dokumente të tjera që vërtetojnë lidhjet e mia me Greqinë dhe grekët. Emigrantët shqiptarë në Greqi mund të bëjnë aplikimin për nënshtetësinë greke pranë Drejtorisë së Gjendjes Civile të Administratës së Decentralizuar të zonës ku jetojnë.

TARIFAT

Të interesuarit për nënshtetësinë greke duhet të paguajnë 700 euro për aplikimin për herë të parë dhe 200 euro për aplikimin për herë të dytë dhe për të gjitha aplikimet vijuese. Ndërkohë personat e deklaruar si refugjatë apo pa nënshtetësi do të paguajnë vetëm 100 euro për aplikimin për herë të parë dhe për të gjitha aplikimet vijuese. Në projektligjin e ri që është paraqitur në parlament taksa prej 700 eurosh, parashikohet të ulet dhe të bëhet 550 euro. Pas aplikimit, kandidatët duhet të presin rreth 1 vit për të marrë përgjigje nëse aplikimi i tyre është pranuar apo jo.

KONTROLLI ONLINE

Gjithë personat që kanë aplikuar për nënshtetësinë greke dhe duan të pyesin se

në ç'fazë ndodhet aplikimi i tyre, tashmë mund të telefonojnë direkt në drejtorinë e nënshtetësisë të Ministrisë së Brendshme. Të interesuarit mund të telefonojnë nga e hëna në të premte (me përjashtim të pushimeve zyrtare), dhe nga ora 10:00 deri në orën 13:00, në numrin e telefonit: (+30) 2131361919. Po ashtu ka dhe një mundësi tjetër: Të interesuarit mund të klikojnë në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme greke, ku në fund djathtas te kutia rozë, me emrin "POREIA KTISIS ITHAJENIAS - Ecuria e marrjes së nënshtetësisë) dhe të ndjekin udhëzimet. Fillimisht ata duhet të klikojnë shërbimin ku e kanë dorëzuar aplikimin në bazë të qarkut, më tej numrin e dosjes, emrin dhe mbiemrin e tyre si dhe të shkruajnë simbolin e verifikimit në fund fare e pastaj shtypin "ANAZITISI".

MARRJA E NËNSHTETËSISË

Prej disa kohësh, Greqia ka lehtësuar procedurat për të gjithë emigrantët shqiptarë që marrin nënshtetësinë greke. Tashmë procedura për kryerjen e shkëputjes nga leja e qëndrimit, mund të kryhet automatikisht. Në momentin që një emigrant shqiptar merr nën-

shtetësinë greke, kjo paraqitet në gazetën qeveritare. Para funksiononte në këtë mënyrë: emigranti duhej të shkoste në Qendrën e Emigracionit ku dhe kishte marrë lejen e qëndrimit, dhe bënte shkëputjen nga kjo leje në mënyrë që të merrte nënshtetësinë. Por kjo ishte një procedurë që zgjaste 2-3 javë. Tashmë procedura është lehtësuar dhe bëhet automatikisht. Megjithatë heqja e lejes së qëndrimit mund të duket një veprim i thjeshtë, në fakt, njerëzve u kushtonte shumë, sidomos të rinjve të brezit të dytë që mund të kishin shans për të shfrytëzuar programe studimi jashtë shtetit, dhe nuk pajiseshin në kohën e duhur me këtë dokumente greke. Kjo sepse nuk mund të paraqiteshin direkt në zyrat e shtetasve të huaj dhe emigracionit, por duhej që më parë të linin një takim, e cili mund të realizohej edhe pas disa muajsh.

Ndërkaq edhe mbajtësit e "kartës së homogjenit", duhej të paraqiteshin në polici për të anuluar kartën e tyre. Pra, gjithë kjo procedurë sillte një zvarritje të panevojshme, në një kohë që gjithçka mund të zgjidhej në mënyrë elektronike nga shërbimet administrative greke.

KATEGORITË APLIKUESE PËR NËNSHTETËSI GREKE

Kur mund të kryhet aplikimi:

- Pas 7 viteve qëndrimi të përhershëm dhe të ligjshëm në Greqi.
- Pas 3 viteve qëndrimi të përhershëm dhe të ligjshëm në Greqi me kusht që të jem martuar me një nënshtetas/e grek/e dhe të kem fëmijë me të.
- Pas 3 viteve qëndrimi të përhershëm dhe të ligjshëm nëse kam një fëmijë në moshë të mitur që ka nënshtetësi greke (nuk aplikohet për ata që e kanë fituar nënshtetësinë sepse kanë frekuentuar një shkollë greke).
- Pas 3 viteve qëndrimi të përhershëm dhe të ligjshëm në Greqi, nëse jam refugjat ose jam pranuar si person pa nënshtetësi nga autoritetet greke.

Dokumentacioni

- Një "deklaratë natyralizimi" pranë bashkisë së vendbanimit.
- Një aplikim për natyralizim.
- Një leje qëndrimi e llojeve të mëposhtme si:**
 - Leje qëndrimi afatgjatë ose leje qëndrimi e brezit të dytë,
 - për bashkëshortët/et e nënshtetasve grekë ose të BE-së, ose një prind i një nënshtetasi grek në moshë të mitur,
 - një refugjat politik ose me mbrojtje të përkohshme,
 - si person pa nënshtetësi
 - Pasaporta.

*Nëse keni lindur jashtë vendit, një certifikatë lindjeje, e vërtetuar dhe e përkthyer në greqisht/ Nëse keni lindur në Greqi, një certifikatë lindjeje greke.

*Auditimet e taksave personale për vitet e fundit.

► Numri i sigurimeve shoqërore (?.?.?.?).

Dokumente të tjera që vërtetojnë lidhjet e mia me Greqinë dhe grekët.

-Kush nuk ka të drejtë aplikimi

- Ata që nuk kanë leje qëndrimi ose kanë vetëm leje të përkohshme.
- Ata që kanë marrë dënime me burg që janë më shumë se 6 muaj, për lloje të caktuara krimesh, ose dënime që janë më shumë se 1 vit për krime që janë kryer me dashje.

Haradinaj: S'ka më taksë 100%, nëse serbët na njohin te ndërkombëtarët

Taksa ndaj Serbisë, SHBA paralajmëron Kosovën: Hiqeni, ose s'ka mbështetje

Administrata amerikane: Do ndalojmë mbështetjen për FSK

Pas një periudhe të kon siderueshme që Koso va vuri taksën 100% ndaj Serbisë, Këshilli i Sigurisë Kombëtare në SHBA dhe Departamenti i Shtetit Amerikan kanë formësuar pozicionin e tyre. Mediat kosovare kanë zbuluar mesazhin e qartë, i cili tashmë iu është transmetuar në formë të shkruar autoriteteve shtetërore kosovare. Ky qëndrim i prerë i administratës amerikane ndaj Kosovës është përmblodhur në tetë pika kryesore, të cilat theksojnë se masa e marrë për të vënë taksën nuk është konsultuar me SHBA.

"Masat tarifore janë marrë pa asnjë konsultim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës".

"Shprehim zhgënjimin e thellë që pas letrës së Presidentit Trump drejtuar Presidentit Thaçi, jo vetëm që nuk ka pasur reflektim pozitiv nga ana e qeverisë së Kosovës, por janë shtuar produktet të cilat i nënshtrohen tarifës".

"Kërkojmë pezullimin e menjëhershëm të tarifës. E njëjta tarifë mund të rivendoset në rast se dështon marrëveshja me Serbinë".

"Mbështetja e SHBA-ve për Kosovën nuk është e pakushtëzuar. Kosova për momentin e bart barrën e rrezikimit të dështimit të dialogut".

"Nëse tarifa nuk suspendohet urgjentisht, SHBA-të do të suspendojnë asistencën në fushën e sigurisë, pra mbështetjen për FSK".

"Suksesi dhe arritja e marrëveshjes nuk ndërlihen me rolin e znj. Federica Mogherini dhe BE-në. Arritja e marrëveshjes është interes strategjik i SHBA-ve, prandaj është e papranueshme për ne vënia në pikëpyetje e këtij qëllimi



Departamenti amerikan i shtetit

strategjik nga ana e veprimeve të papërgjegjshme të liderëve kosovarë".

"Në rast se marrëveshja dështon për shkak të Kosovës, barrën e përgjegjësisë dhe pasojat do t'i bartë vetë Kosova dhe individët përgjegjës për këtë dështim".

"Kosova me sjelljet e saj të papërgjegjshme po e rrezikon seriozisht miqësinë me SHBA-të".

"Klan Kosova" gjithashtu e ka të konfirmuar që me kërkesë të Shtëpisë së Bardhë, ky mesazh është përcjellë tek pesë institucionet të rëndësishme shtetërore të Kosovës nëpërmjet kanaleve diplomatike. Ndërkaq, kryeministri i Ko-

sovës, Ramush Haradinaj ka thënë dje se pa garanci ndërkombëtare që marrëveshja përfundimtare Kosovë-Serbi do të rezultojë me njohje, taksë do të vazhdojë të mbetet në fuqi. Haradinaj në një postim në rrjetin social "Facebook" shkruan se është thellësisht i bindur për mundësinë e arritjes së marrëveshjes gjithëpërfshirëse ligjërish obliguese me Serbinë, që rezultim me njohje. Kryeministri shkruan se Qeveria e Kosovës do ta pezullonte përkohësisht taksën, vetëm pas garancisë ndërkombëtare, se do të ulen për ta nënshkruar marrëveshjen përfundimtare, e cila duhet të rezultojë me

njohjen reciproke.

POSTIMI NG HARADINAJ

"Përdërisa kemi vetëm sugjerime për takime dialoguese të pafrytshme, pa objektiv dhe pa afate qartë të përcaktuara, pa kontratë të paradakorduar dhe garanci ndërkombëtare, që do të nënshkruhet marrëveshja përfundimtare që rezultim me njohje, taksë vazhdon të mbetet në fuqi. Jam thellësisht i bindur për mundësinë e arritjes së marrëveshjes gjithëpërfshirëse ligjërish obliguese me Serbinë, që rezultim me njohje. Ne intensivisht po punojmë për një kontratë përfundimtare, marrëveshje finale, me ç'rast

MESAZHI I SHBA NDAJ KOSOVËS

■ "Masat tarifore janë marrë pa asnjë konsultim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës".

■ "Shprehim zhgënjimin e thellë që pas letrës së Presidentit Trump drejtuar Presidentit Thaçi, jo vetëm që nuk ka pasur reflektim pozitiv nga ana e Qeverisë së Kosovës, por janë shtuar produktet të cilat i nënshtrohen tarifës".

■ "Kërkojmë pezullimin e menjëhershëm të tarifës. E njëjta tarifë mund të rivendoset në rast se dështon marrëveshja me Serbinë".

■ "Mbështetja e SHBA-ve për Kosovën nuk është e pakushtëzuar. Kosova për momentin bart barrën e rrezikimit të dështimit të dialogut".

■ "Nëse tarifa nuk suspendohet urgjentisht, SHBA-të do të suspendojnë asistencën në fushën e sigurisë, pra mbështetjen për FSK".

■ "Suksesi dhe arritja e marrëveshjes nuk ndërlihen me rolin e znj. Federica Mogherini dhe BE-në. Arritja e marrëveshjes është interes strategjik i SHBA-ve, prandaj është e papranueshme për ne vënia në pikëpyetje e këtij qëllimi strategjik nga ana e veprimeve të papërgjegjshme të liderëve kosovarë".

■ "Në rast se marrëveshja dështon për shkak të Kosovës, barrën e përgjegjësisë dhe pasojat do t'i bartë vetë Kosova dhe individët përgjegjës për këtë dështim".

■ "Kosova me sjelljet e saj të papërgjegjshme po e rrezikon seriozisht miqësinë me SHBA-të".

edhe dorëzuar librin e madh me kapituj dhe draftin e kësaj marrëveshjeje. Tërë këtë përmbajtje e kemi zhvilluar me qëllim për t'u siguruar se kur ulemi me Serbinë të kemi materiale të qëndrueshme, me fakte dhe argumente. Vendosja e taksës ndaj produkteve të Serbisë nuk ka për qëllim pengimin dhe prolongimin e arritjes së marrëveshjes gjithëpërfshirëse ligjërish obliguese me Serbinë, që rezultim me njohje".

zulton me njohje. Përkundrazi, Qeveria e Kosovës do ta pezullonte përkohësisht taksën, vetëm pas garancisë ndërkombëtare se do të ulemi për ta nënshkruar marrëveshjen përfundimtare, e cila duhet të rezultojë me njohjen reciproke. Garanci do të thotë që ekziston një materie, kontratë e dakorduar në parim dhe pret vetëm nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, që rezultim me njohje".

Aleksis Tsipras, vetëm pak kohë pas largimit të Panos Kamenos nga qeveria e koalicionit dhe dy ditë pas ndryshimeve të votuara kushtetuese në Maqedoni, në konferencën dedikuar Marrëveshjes së Prespës, teksa uroi homologun e tij të Maqedonisë, Zoran Zaev u shpreh se me marrëveshjen e re, Greqia është liruar nga llogjika e nacionalizmit. "Të njëjtën e arriti edhe Zoran Zaev me qeverinë e tij, duke e vulosur tërë tentimin me revizionin e guximshëm kushtetues përmes të cilit sigurohet jetëgjatësia e kësaj marrëveshjeje. Më lejoni t'i uroj që këtu, sepse është hera e parë që flas pas përfundimit pozitiv të procesit në Shkup. Më lejoni t'i uroj kryeministrit të Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, për guximin që e tregoi që nga fillimi e deri në fund të këtij procesi. T'i uroj sepse nuk hoqi dorë para protestave nacionaliste të urrejtjes, të cilat atje i orga-

Marrëveshja e Prespës, Tsipras: Uroj Zaev për guximin që tregoi

Rrudhen votat e "Grekëve të Pavarur", kryeministri i Greqisë do ta provojë sërish

nizonte VMRO-ja, partneri i Demokracisë së Re në Partinë Popullore Evropiane, që investoi në dhunën dhe në provokimin e anomalisë politike duke tentuar ta anulojë këtë tentim historik", tha kryeministri grek. Aleksis Tsipras e shfrytëzoi rastin për të dhënë mesazhe deri te grekët se nuk do të heq dorë. "Dua të transmetoj edhe një mesazh deri tek qytetarët grekë dhe veçanërisht tek do qytetar që mendon lirshëm, pavarësisht bindjeve të tij politike. Siç atje nuk hoq dorë, as ne nuk do të heqim dorë. Këtë e them, sepse me plane të ngjashme për destabilizim politik jemi përballur dhe përballemi edhe këtu, në vendin tonë", porositi Tsipras, duke

vënë në dukje problemet me të cilat përballtet Greqia, si gjuha e urrejtjes, keqpërdori i nxënësve, por edhe rasti i fundit me publikimin e të dhënave të rreme të deputetëve. Mocioni i votëbesimit për kryeministrin grek, Aleksis Tsipras do të votohet të mërkurën. Vendimin e mori kryeparlamentari Nikos Vucis, i cili tha se debatet do të nisnin që të martën. Ka shpresa që qeveria Tsipras t'i mbijetojë mocionin. Pas largimit të "Grekëve të Pavarur", aleatëve kryesorë në koalicionin qeverisës, deputetë të kësaj partie, Ministria e Turizmit, Eleni Kontura dhe z.v.ministri i Zhvillimit Bujqësor, Vasilis Kokalis shprehën publikisht mbështetjen për qeverinë. Kreu i

"Grekëve të Pavarur", Panos Kamenos vendosi t'i përjashtojë dy deputetët nga grupi parlamentar. Me afirmim e dy deputetëve të "Grekëve të Pavarur", Tsipras garanton një mbështetje prej 148 votash në parlament, tre më pak se numri i nevojshëm për t'i mbijetur mocionit. Nuk përjashtohet mundësia që qeveria të mbështetet edhe nga tjerë deputetë opozitarë. Nëse Tsipras arrin të sigurojë të paktën 151 vota në parlament, ky do të ishte një ogur i mirë edhe për marrëveshjen e Prespës për emrin e ri të Maqedonisë. Marrëveshja pritet të votohet brenda këtij muaji dhe kryeministri shprehu bindjen se ajo do të miratohet.

Daçiç: Kosova dhe anëtarësimi në BE, prioritetet kryesore të Serbisë

Ivica Daçiç, ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë, tha ditën e djeshme se dy prioritetet më të rëndësishme të Serbisë për vitin 2019 janë ruajtja e interesave në Kosovë dhe anëtarësimi në Bashkimin Evropian. "Nuk do të heqim dorë nga angazhimi ynë për dialog dhe për kompromis, në mënyrë që të gjejmë një zgjidhje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Serbia mbetet e përkushtuar ndaj parimeve të së drejtës ndërkombëtare", ka thënë Daçiç në një dalje para mediave. "Ne jemi për marrëveshje me Prishtinën, mirëpo ndaj do veprimi të tyre të njëanshëm do të reagojmë me forcë për të mbrojtur interesat tona", tha shefi i diplomacisë serbe.

IVICA DAÇIÇ

"Nuk do të heqim dorë nga angazhimi ynë për dialog dhe për kompromis, në mënyrë që të gjejmë një zgjidhje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Serbia mbetet e përkushtuar ndaj parimeve të së drejtës ndërkombëtare", ka thënë Daçiç.

Përgatitjet për Brexit, 100 parlamentarët europianë: Dera jonë është e hapur

Deputetët e BE-së, letër Britanisë: Ju lutemi, qëndroni

May mund të ndalojë Brexit sesa të dalë pa marrëveshje

100 deputetë të Parlamentit Europian i dreg tohen me një letër Britanisë së Madhe vetëm pak para votimit në Londër për marrëveshjen e Brexit që kryeministria, Theresa May arriti me BE. Kryeministria britanike pret shtyrjen e Brexitit. "Ne ju lutemi që për interesin e gjeneratës së ardhshme të rimendoni daljen nga BE", thuhet në një letër të eurodeputetëve. "Çdo vendim britanik për të qëndruar në BE do të përsëritet prej nesh dhe do të punojmë së bashku për të reformuar dhe përmirësuar Bashkimin Europian". Më tej eurodeputetët shkruajnë se "e kanë vlerësuar jashtëzakonisht ndikimin e politikave dhe qytetarëve britanikë në 40 vitet e fundit. Do të na mungojë aftësia e dija e kolegëve britanikë". Një nga nënshkruesit e kësaj



letre, politikanin gjerman CDU-së, Peter Liese u shpreh për grupin mediatik gjerman, Funke Mediengruppe se, "ne duam të japim një sinjal për popullsinë dhe me këtë edhe Dhomës së Ulët e të bëjmë të qartë - nëse britanikët vendosin të qën-

drojnë, ata janë përzemërsisht të mirëpritur". Eurodeputeti konservator gjerman shton se "zemra dhe dera jonë është e hapur". Parlamentin britanik voton të martën (15.01.) për marrëveshjen e Brexit të arritur me shumë vështirësi nga

kryeministria Theresa May dhe BE. Refuzimi i kësaj marrëveshjeje në parlament konsiderohet mjaft i mundur. Pika qendrore e kontestuar është si mund të menjahohen kontrollat mes provincës së Irlandës së Veriut dhe vendit anëtar të BE, Irlandës, kjo edhe për të penguar rindezjen e konfliktit në Irlandën e Veriut. Nga ana e saj, kryeministria britanike, Theresa May sheh si skenar më të mundshëm ndalimin e Brexit se sa një dalje pa marrëveshje. "Ka disa në Westminster që duan ta vonojnë apo ndalojnë Brexitin dhe do të përdorin çdo mjet për të ndaluar këtë", thuhet në fjalimin e publikuar. Ndërkohë BE sipas informacioneve të ndryshme po përgatitet për një shtyrje të daljes së Britanisë së Madhe deri në kor-

U shpall fajtor për kontrabandë droge, dënohet me vdekje kanadezi

Një qytetar kana dez është akuzuar për trafikim lëndësh narkotike në Kinë dhe është dënuar me vdekje nga një gjykatë kinëze. Një rast i tillë me shumë gjasa mund të acarojë marrëdhëniet midis Otavës dhe Pekinit. Një ish-punëtor i naftës, Robert Lloyd Schellenberg, fillimisht u arrestua në vitin 2015, me dyshimin për kontrabandën e më shumë se 200 kilogramëve drogë në Kinë. Në nëntor 2018, ai u dënua me 15 vjet burg dhe një gjobë në shumën 150,000 juan (22,185 dollarë). Kanadezi, i cili pretendon të jetë i pafajshëm e apeloj rastin e tij, por ankimi i tij me sa duket u dëmtoi, pasi prokurorët kinëzë konsideruan dënimin e tij të butë dhe kërkuan një më të ashpër. Dëshmia e marrë nga hetuesit "sugjeron se Schellenberg ishte i përfshirë në krimin e organizuar ndërkombëtar të drogës", argumenton prokuroria. Ligjet e rrepta të drogës të Kinës zbatojnë një dënim prej "15 vjet burgim, të përjetshëm, ose vdekje" si dhe konfiskimin e pasurisë për trafikimin e drogës në sasi mbi një kilogramë. Kina ka ekzekutuar kontrabandistët e huaj të drogës më parë: si shtetasin britanik Akmal Shaikh, i cili u vra në vitin 2009, pavarësisht protestave nga autoritetet britanike, për kontrabandë mbi katër kilogramë heroinë.



rik. "The Guardian" shkruan se Brexiti i planifikuar më 29 mars nuk duket realist në Bruksel, për shkak të rezervave të mëdha në parlament. Pritet që javët e ardhshme të vijë një kërkesë nga Londra për një shtyrje "teknike" të procesit të daljes nga BE.



S.W.A.N
ALBANIA

SWAN Albania është një projekt i cili ndihmon në informimin mbi ripërdorimin e mbetjeve të ngurta në Shqipëri dhe në Ballkan

VENDNDODHJA E AKTIVITETEVE

Projekti do të mbulojë katër vende, përkatësisht Greqinë, Shqipërinë, Qipron dhe Bullgarinë.

- Në Greqi, zona e aplikimit do të jetë Rajoni i Atikës, ku LP vepron si organi publik rajonal përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve të ngurta. Rajoni i Attikës përfshin të gjithë zonën metropolitane të Athinës, kryeqytetin e Greqisë. Rreth 3.750.000 njerëz jetojnë në rajon (afërsisht 40% e popullsisë greke), duke krijuar gati 45% të totalit të mbetjeve të vendit. Do të kryhet një inventarizim i plotë dhe hedhja në hartë e të gjitha burimeve të mundshme dhe potenciale të mbetjeve të ngurta, duke përfshirë ndërmarrjet e vogla, të mesme dhe të mëdha, me karakteristika sasiore dhe cilësore (duke përfshirë karakteristikat hapësinore, kategorizimin e materialeve / plastikës / mbetjeve organike etj.). Kërkesat për trajtim para ripërdorimit.) Në të njëjtën kohë, një njësi unike e menaxhimit dhe ruajtjes së mbetjeve për mbetjet e ngurta, të vendosura në Attikë dhe të kontrolluara nga LP, do të kapitalizohen si një shtrat testues për qëllimet e SWAN, me qëllim të testimit të zbatimit të modeleve të zgjedhura të biznesit dhe kontributit aspektet e qëndrueshmërisë së projektit. Në vendet partnere të mbetura, aktivitetet e projektit do të kryhen në nivel kombëtar. Të gjitha industritë e mesme dhe të mëdha do të regjistrohen, së bashku me karakteristikat e flukseve të mbetjeve të ngurta që janë në dispozicion. Objektivat paralele do të jetë identifikimi i rajoneve që mund të shërbejnë si bazë për zhvillimin e grupeve simbioze industriale të bazuara në mbetjet e ngurta. Përveç kësaj, partnerët e projektit në Shqipëri, Qipro dhe Bullgari do të kontaktojnë me aktorët e përzgjedhur në rajonet e identifikuar, me qëllim të validimit të modeleve të propozuara të biznesit dhe planifikimit të financimit të mëtejshëm për t'i zbatuar ato, duke siguruar kështu vazhdimin e trashëgimisë SWAN. Osi pjesë e EP6, partnerët SWAN do të hartojnë dhe dorëzojnë një plan qëndrueshmërie, i cili do të zhvillohet rreth shtyllave të mëposhtme:

-1. Ekosistemi Dixhital i SWAN-it (SWAN DE). Duke pasur 4 platforma ndërvepruese të TI-së që formojnë SWAN DE ofron një bazë të mirë për planifikimin e shkallëzimit. Ne do të identifikojmë strukturat dhe funksionet dhe do të eksplorojmë ekuilibrin e duhur mes atyre që kontrollohen nga një ekip i centralizuar, krahasuar me ato që

menaxhohen më mirë 'në nivel lokal', nën kontrollin e secilës platform. Qëllimi është të krijohet dhe të provohet udhëzimet e zhvillimit fleksibël të platformës (përkrahur në rezultatet kyçe: dizajne funksionale dhe teknike, manuallet operacionale, raportet e modelit të biznesit) që do të: a) logaritën parametrat aktualë të SWAN DE; b) të balancojë qasjet e centralizuara dhe të shpërndara; c) udhëzojë pjesëmarrësit e ardhshëm që të zhvillojnë platformat e tyre lokale si komponentë "plug-and-play" të SWAN DE. Kjo do të rrisë tërheqjen (dhe kështu përdorimin e) SWAN DE, pasi ai do të thjeshtojë furnizimin dhe qasjen nga përmbajtja e ruajtur në ekosistem (p.sh. ngarkoni detajet e rrjedhës së mbeturinave, kërkoni për furnizues ose blerës etj.). Përveç kësaj, një qasje e tillë do të bëjë bashkimin me SWAN DE një proces që është i pavarur nga vendndodhja e aktorëve të platformës / pjesëmarrësve, duke kontribuar drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë dhe përsëritjen e projektit.

- 2. Ekosistemi Industrial i SWAN-it (SWAN IE). Të gjithë aktorët që do të marrin pjesë në aktivitetet e shpërndarjes së projektit (dhe do të marrin përfituesit e rezultateve të projektit) do të inkurajohen që të bëhen anëtarë të SWAN IE (që është një nga rezultatet e pritura të WP6). Ky rrjet do të sjellë së bashku aktorë në rajonin e Ballkanit Med, në mënyrë që të bashkë-zhvillojnë idetë e projektit, kërkojnë fonde të ardhshme dhe përfundimisht të zbatojnë një rrjet simbiotik lokal bazuar në ripërdorimin e mbeturinave të ngurta Përveç kësaj, zhvillimi i rekomandimeve të politikave për promovimin e zinxhirëve të vlerave të ripërdorimit të mbeturinave të ngurta, si një prej rezultateve kryesore të projektit, si dhe prezenca në IEEE SWAN (si pjesëmarrës në projekte) të dy krijuesve kryesorë të politikave (ministratë greke dhe shqiptare të Mjedisit) garanton që rezultatet kryesore të projektit do të informojnë ose madje do të udhëheqin vendimet e ardhshme për politikën dhe planet e veprimt.

Së fundi, përdorimi i mediave sociale do të synojë krijimin e faqes virtuale të SWAN IE, përmes zhvillimit të komunitetit si një mjet për zgjerimin e SWAN IE përtej zonës së projektit.

OBJEKTIVI

Objektivi kryesor është zhvillimi i një ekosistemi të ripërdorimit të mbeturinave të ngurta, në mënyrë që: a) të përcaktojë vendndodhjen në hartë të burimeve të mbetjeve të ngurta dhe marrësit e mundshëm të rrjedhave të mbetjeve; b) propozojë rrugët e ripërdorimit të mbetjeve të mundshme.

Prapaskenat e filmit "Dashuria s'mjafton", raporti me Drilon Hoxhën

Avni Kurti:

Në jetë çdokush merr "gjoba", ja pse u pëlqye "Jam nana"

"Fama erdhi kur nuk u mendua"

Egla Xhemali

Një nga fenomenet më të spikatura të vitit ka qenë padyshim taksixhiu "Nana". Avni Kurti me origjinë nga Burreli dhe banues në Tiranë, për shumë kohë u bë kryefjalë e takimeve të personazheve publikë dhe jo publikë. Realiteti i kohës, humori, natyra e çiltër dhe pasioni për makinat bënë që me anë të disa videove të shkurtra, taksisti Avni të rrembente vëmendjen e të gjithëve. Shumë polemika u ngjallën, por që e shndërruan atë në personazhin më të dashur për publikun duke i dhënë benefite si personale ashtu edhe profesionale. Pasi videot bënë xhiron e rrjetit u sqarua që protagonistin do ishte pjesë e një filmi shumë të diskutuar të momentin ndaj u dha dhe kjo vëmendje e madhe. Edhe pse videot janë realizuar në mënyrë spontane vëmendja e personazhit i ishte dhënë nga regjisori Drilon Hoxha duke e bërë pjesë të projekteve të tij për tipin dhe çiltërsinë si karakter. Kurti vjen në një rrafshin për "Gazeta shqiptare" për të hedhur dritë mbi pikëpyetjet e njerëzve. Ai ndan me ne përjetimet në filmin "Dashuria s'mjafton", ardhjen e menjëhershme të famës, për suksesin e Nanës. Avniu pohon se në çdo ambient është timonieri më i mirë dhe se çdokush në jetë merr gjoba. Më tej ai zbulon nëse do jetë pjesë e projekteve të tjera.

Për shumë kohë keni qenë në qendër të vëmendjes së mediave rozë. Si erdhi fama te ju?

Fama, në fakt, erdhi kur nuk u mendua. Ndodhi në mënyrë shumë spontane dhe mori një bujë të madhe emri im bashkë me shprehjet specifike në video. Gjëja më e mirë dhe që më ka gëzuar pa masë ka qenë reagiimi i fansave kundrejt meje me komente pozitive. U bëtë i njohur me lançimin e një videoje dhe



u identifikuar si personazhi "Jam nana". Çfarë e bën të veçantë këtë personazh?

E veçanta e këtij personazhi është se nuk u krijuar për ndonjë përfitim personal nga vete unë, njerëzit e kri-

juan dhe e bën pjesë të tavolinave të tyre. Pra, aq si personazh "Nana" është shumë popullor, spontan dhe pozitiv.

Si erdhi oferta për t'u bërë pjesë e filmit "Dashuria s'mjafton"?

Unë Drilonin e njoh kohë më parë, dhe kam qenë në dijeni të filmit "Dashuria s'mjafton". Pasi "testuam" videot, të cilat pushuan rrjetet sociale, e menduam që në mbështetje të tyre të vazhdoj të kem dhe një rol në film për të ardhur në një rol tjetër për ata që më ndjekin.

Sa e vështirë ka qenë të realizojë skena filmi?

Është hera e parë që unë marr pjesë në një film, dhe ka qenë një eksperiencë shumë e bukur për mua. Me ndihmën e stafit dhe të Drilonit ja arrita më së miri pa vështirësi.

Dubla që e keni përsëritur disa herë?

Vetëm një herë e kam përsëritur dublën.

Cila është pjesa më e sikletshme me taksistët në Shqipëri?

Pjesa më e sikletshme është kur përballesh çdo ditë me njerëz dhe karaktere të ndryshme ku shumica akoma nuk kanë kulturën dhe komunikimin.

Çfarë lloj "timonieri" jeni në shtëpi?

Në çdo ambient (jo vetëm në shtëpi) jam "timonieri" më i mirë pa dyshim. (qesh)

"Gjoba" më e madhe që keni marrë ndonjëherë?

Nëse referohesh në gjoba për qarkullimin rrugor: që në vitin '92 vetëm një herë kam dal në komisjon. Ndërsa për "gjobat" në jetë, padyshim që çdo njeri merr, e rëndësishme është që ato gjoba t'i kthejmë në dëmshpërblime dhe them se ia kam arritur.

Cili është ai ves që e keni që nga fëmijëria?

Që fëmijët, në fakt, kështu kam qenë, tip i shoqërueshëm, bëja gjithmonë humor, por kisha dhe atë tipin e "garipit" në shoqëri dhe isha gjaknxehtë. Megjithatë nuk mund të them që jam akoma pasi me moshën në kuptojmë shumë gjëra dhe ndryshojmë nga



fëmijëria. **Do i thoni ndonjëherë "Stop" aktrimit?**

Në fakt, tani që e provova

nuk e di, besoj se do më pëlqente ta vazhdoja nëse ofertat do ishin të mira. Pse jo!



Oriola Marashi më seksi se kurrë, këto foto po "djegin" rrjetin

Oriola Marashi ka sfiduar të ftohtin dhe ka sjellë një version të ri të 'kësulëkuqes'. Modelja është 'kësulëzeza' sexy me bikini që mban hedhur një mantel transparent. Ashtu siç pritej, ky postim provokues i anëtares së OTR ka zgjuar shumë reagime mes fansave të saj. Kujtojmë se super modelja seksi është përfolur se do vijë shumë shpejt me një këngë për t'u bërë kështu edhe pjesë e tregut muzikor në vend.



'Njëra e madhe, tjetra e vogël', Ledri Vula ka zbuluar femrat që e presin në shtëpi

Ledri Vula është padyshim një prej reperëve më të talentuar shqiptarë si dhe konsiderohet si një prej meshkujve më seksi, e si rrjedhojë fanset femra janë të mëdha në numër. Mjaft publike ka qenë lidhja e Ledrit me Dafina Zeqirin, pas saj çdo gjë dimë për jetën e tij private janë aludime dhe Ledri deri më tani nuk na ka prezantuar me ndonjë të dashur. E megjithatë, së fundmi ai vendosi të na zbulonte me dy femrat që e presin atë në shtëpi. Janë pikërisht gjyshja e tij dhe macja. Ledri ka fotografuar të dyja në tavolinën e shtëpisë, mbi foto reperi shkruan: "Më e madhja dhe më e vogla e shtëpisë".



Shifra marramendëse për veshje, Marina dhe Getoari nuk dinë të ndalen për shopping.

Rreth dy ditë më parë, bëri xhiron e rrjetit çmimi marramendës i xhaketës ngjyrë blu të Marina Vjollcës, që mbante veshur në foton e postuar në 'Instagram'. Xhaketa e moderatorës kushtonte plot 6845 euro, ç'ka bëri që të komentohej shumë në mediat rozë. Mirëpo siç duket edhe Geti, bashkëshorti i saj, nuk mbetet pas, ai është i apasionuar pas veshjeve të shtrenjta.

Komente të shumta vijnë edhe për xhaketa e tij, e cila kushton më pak se e Marinës, por sërish e shtrenjtë. Faqja "Ehattheywearin" bën të ditur se xhaketa e reperit kushton 1300 euro ndërsa pantallonat 890 euro.



Fjolla Morina në alarm, ja çfarë i ka ndodhur vajzës së saj

Fjolla Morina, këngëtarja shumë e dashur për publikun, rreth katër vite më parë solli në jetë vajzën e saj të dytë, Alayah. Që kur Alayah ishte foshnjë, këngëtarja postonte shpesh foto me të dhe tanimë që vogëlushja është plot 4 vjeç është kthyer në një modele të vërtet dhe një nga fëmijët më të bukur të 'Instagramit'. Së fundmi ishte e ftuar në "Thumb", Fjolla ka treguar se duke postuar shpesh foto me vajzën, atë e kanë marrë mësysh dhe tregoi se Alayah ka filluar t'i qajë natën. "Nuk po publikoj më foto dhe video me vajzën se po më qan natën. Po e marrin mësysh. U bëra dhe unë pjesë e mamave që mendojnë kështu",-u shpreh Fjolla.



INTERVISTA SPECIALE

Dashnor Kaloçi

Historia e panjohur se si shpëtoi Uran Butka nga arrestimi në Krujë, pas ndërhyrjes së sekretarit të parë, Pirro Kondit


Uran Butka: Mis Durham e ka quajtur Safet Butkën zemra e nacionalizmit shqiptar

Dëshmia: "Safet Butka deklaroi: Nuk kemi dalë të vrasim shqiptarët dhe se të parin e të vetmin shqiptar që unë mund të vras, është vetja ime"

Historian, studiues, publicist, shkrimtar, piktor, politikan dhe ish-deputet, Uran Butka, një nga personazhet publike mjaft të njohur pas viteve '90-të, edhe pse mban plot tetë dekada mbi supe, vazhdon përsëri të punojë, madje me energji të jashtëzakonshme sikur kërkon t'i bëjë sfidë jo vetëm moshës, por edhe gjithë asaj periudhe kohe të errët për të, të para viteve '90-të, kur regjimi komunist ua kishte privuar të drejtën e shkrimeve, studimeve dhe librave, prej të cilave ai thotë se do jenë bashkudhëtar të tij të pandarë deri në fund të jetës, sa të ketë frymën gjallë. I zhytur mes librave në studion e tij të punës, diku në qendër të kryeqytetit pranë Institutit "Lumo Skëndo", që ai drejton prej pak vitesh, duket se ende nuk e ka marrë veten nga një punë tejet e çmuar për të, madje do të thoshim pa e tepruar edhe një ëndërr e tij, ajo e sjelljes në atdhe të eshtrave të Mi'had Frashërit, idhullit të tij dhe njëkohësisht kreut të nacionalizmit shqiptar. Autor i shumë librave, si atyre me studime të karakterit historik, por edhe letrues i letërsisë me romane dhe libra me tregime, Uran Butka pothuaj nuk ka folur dhe shkruar kurrë për jetën e tij. Kjo është edhe një nga arsyt që na shtynë të takohemi dhe të realizojmë këtë intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", (në tre numra radhazi) por jeta me historitë e tij personale nuk mund të shkëputet kurrsesi nga saga e familjes Butka, të cilët janë quajtur me të drejtë si gurë të fortë e të çmuar e në themel e historisë shqiptare. Kështu në këtë kontekst, po e fillojmë nga rrënjët e kësaj familjeje, që është e njohur nga patrioti i madh, Sali Butka, për të vazhduar më pas me të birin, Safetin dhe së fundmi me atë se çfarë ndodhë me vetë Uranin e familjen e tij gjatë regjimit komunist të Enver Hoxhës?


(vijon nga numri i djeshëm)

Safeti e kishte njohur mirë teorikisht dhe praktikisht se ç'ishte komunisti, thelbi i tij antikombëtar dhe antinjerëzor, ndaj zgjodhi alternativën e Rilindjes, atë nacionaliste. Ai shkoi në Kolonjë dhe krijoi çetën e parë nacionaliste, mandej në Korçë u zgjodhi kryetar i çetave nacionaliste të qarkut të Korçës dhe pati mjaft luftime kundër italianëve. Mesazhi dhe përplekja e tij ishte: "Paqe mes shqiptarëve, luftë kundër pushtuesve të huaj". Ai ishte misionar i marrëveshjes dhe i bashkëpunimit mes sh-



tjera shqiptare, që pastaj imponuan Marrëveshjen e Mukjes. Mirëpo, pas prishjes së Marrëveshjes së Mukjes nga komunistët dhe misionarët e Beogradit Dushan Mughosha dhe Miladin Popoviq, shqiptarët u vunë në luftë kundër shqiptarëve. Konferenca e Labinotit, 4 deri në 8 shtator 1943, vendosi për luftën e armatosur kundër nacionalistëve, kështu u dha urdhri i sulmit nga Enver Hoxha kundër tyre, jo vetëm kundër Ballit Kombëtar, por edhe të nacionalistëve të tjerë psh., kundër Abaz Kupit, Muharrem Bajraktarit, kundër vëllezërve Kryeziu etj., që luftonin më vete kundër italianëve dhe gjermanëve.

Ç'ndodhi me Safet Butkën pikërisht në këtë kohë kur ndodhin këto ngjarje?



Safet Butka vijonte të luftonte kundër pushtuesve, madje edhe në betejë të përbashkëta me partizanët. Kemi një raport të Mis Durham "Çetat nacionaliste", ku tregon për çetat edhe luftarët e prof. Safet Butkës, që e quan zemra e nacionalizmit shqiptar. Luftën e parë kundër italianëve e kanë bërë çetat e Safet Butkës me 350 luftëtarë, poshtë afërës së Qarrit, në Floq, më 23 janar 1943. Po ashtu, luftimet në Voskopojë, Gjonmadh etj. Në këtë kohë ai organizoi edhe një betejë bashkë me partizanët në Pocerestë afër Korçës, kundër një autokolone italiane: në një krah ishin vendosur çetat e Safet Butkës dhe nga ana

tjetër, çetat partizane të Nexhip Vinçanit dhe patën dhe dëshmorë të përbashkët. Vetë fakti që në këtë betejë është vrarë Nexhip Mileci, nacionalist dhe dy partizanë, tregon se janë dëshmorë të një lufte të përbashkët antifashiste.

Cilën do të veçimtondonjë nga betejat më të njohura që ka marrë pjesë dhe udhëhequr babai juaj, Safet Butka?

Beteja më e madhe e organizuar nga Safet Butka kundër gjermanëve është ajo në kthesat e Barmashit, më 13 gusht 1943, në bashkëpunim me forcat britanike, sepse Butka bashkëpunoi me misionarët britanikë B. Maklin, shëf e misionit britanik dhe Dejvid Smajlin, me të cilët ka pasur edhe letërkëmbim. (Letrat janë në Arkivin e Shtetit).

Më konkretisht, ç'ndodhi në këtë betejë?

Aty shkuan 800 luftëtarë nacionalistë me në krye Safet Butkën, pra në Vithkuq, ku qëndronte misioni britanik dhe atje kanë bërë marrëveshjen Maklin-Butka (Arkivi i Shtetit F. 250, D.40 viti 1943) për luftë të përbashkët në krah të aleatëve antifashistë në disa betejë kundër italianëve dhe gjermanëve. Pikërisht një nga këto betejë ishte ajo në kthesat e Barmashit, jo lufta që u bë në korrik 1943 nga Batalioni "Tomorri" kur u dogj Barmashi, Borova dhe u masakruan 107 viktima. Ndërsa, në kthesat Barmashit, u evakuuan banorët e fshatrave afër, që të mos dëmtoheshin. Në këtë betejë mori pjesë edhe kapiteni anglez Dejvid Smajl (madje kam edhe unë një dhuaratë prej tij, librin "Me detyrë në Shqipëri", me dedikim: bir-it të Safet Butkës). Pas bete-

jës kundër një autokolone gjermane që vinte nga Korça për të shkuar në Janinë, u vranë 25 gjermanë dhe u shkatërruan disa autoblinda. David Smajli u mori shenjat identifikuese të gjermanëve të vrarë, për t'i dërguar si dëshmi në Britani. Kjo ishte një betejë shumë e rëndësishme e çetave të Safet Butkës kundër gjermanëve (D.Smajli, botimi "Me detyrë në Shqipëri, Londër). I thashë këto për të dëshmuar që kundër pushtuesve gjermanë kanë luftuar edhe nacionalistët antifashistë. Mirëpo, pas prishjes së Marrëveshjes së Mukjes, filloi lufta civile e nxitur nga jugosllavët, sepse ata donin që shqiptarët të futeshin në luftë me njëri-tjetrin, që të tërhiqnin pas qerres së tyre edhe Kosovën, edhe Shqipërinë si republikë e shtatë e Jugosllavisë.

A mund të ndalemi pak të ngjarja ku humbi jetën babai juaj, Safet Butka?

Natyrisht edhe kjo gjë ndodhi kur mesymja komuniste në luftën për pushtet dhe për komunistizim, përfshiu gjithë krahinat e Shqipërisë në një luftë shkatërrimtare dhe e përgjakshme. Edhe Safet Butka, që ishte misionar i bashkimit mes shqiptarëve dhe i bashkëpunimit në luftën për liri, u rrethua më 19 shtator 1943 nga forcat komuniste në Teqen e Melçanit, një teqe e lartë, si një kështjellë, ku Safeti kishte mjaft ushtri dhe mbështetës. Ishin pikërisht forcat nacional-çlirimtare, të komanduara nga Nexhip Vinçani, që para katarit ditësh nga kjo datë, kishin luftuar bashkërisht në Pocerest kundër italianëve dhe tani ishin urdhëruar të luftonin kundër Safet Butkës. Në atë kohë aty disa anëtarë të Komitetit Qarkor të Ballit Kombëtar Korçës, thoshin që t'u bëjm komunistëve. Safet Butka nuk pranoi: "Nuk kemi dalë të vrasim shqiptarët" dhe deklaroi: "Të parin dhe të vetmin shqiptar që unë mund të vras, është vetja ime". Kështu, ai vrau veten që të mos niste luftën vëllavrasëse



Kolonja, e gjeta nënën duke e lexuar këtë artikull. Ishte e tmerruar.

Të mbetemi te periudha kur filloj persekucioni ndaj familjes suaj?

Po, nëna pas internimit punonte punëtore krahu në Ndërmarrjen e Ndërtimit "Muhamet Gjollësia" në Tiranë, ku prodhoheshin pllakat e cimentos, me duar të çara dhe shpirt ndër dhembë. Na ushqeu dhe na rriti me halle, por kishte merakun shkollës, e ushqyer edhe nga Safeti, se gjithmonë nga Ventotene ai i shkruante: "Mos i ndaj fëmijët nga shkolla dhe nga puna, që të marrin edhe edukatën e punës". Ndërkohë, mendohej të mos dukej nëpër Tiranë, lëvizte si një hije, vetëm shkonte në punë dhe kthehej, sepse kishte frikën e një internim tjetër.

Si ju lanë në Tiranë ku si familje, kur Safet Butka konsiderohej armiku më i madh i komunistëve?

Do t'ju shpjegoj edhe atë gjë, por në parantëz po ju tregoj një ngjarje: Në ishim vendosur me banim jo në shtëpinë tonë që ndërtoi Safeti me kredi dhe ku linda unë, por në një dhomë në shtëpinë e Cen Kazazit, doktori popullor i kockave. Ai na strehoi në fillim me qira dhe më pas nuk na merrte as qira. Një ditë gratë e lagjes erdhën në atë shtëpi dhe i futën krahun nënës, duke i thënë se kishin një mbledhje të rëndësishme të kinema "17 Nëntori". Ajo s'shkonte kurrë nëpër mbledhje, por e morën bashkë me gruan e Cen Kazazit dhe u ulën në një rresht karigresh të kinemasë. Përparsa se të fillonte mbledhja, ku do të fliste një udhëheqës, doli në skenë një ushtarak, që në fakt ishte nip i Safet Butkës, nga ana e nënës së tij. Ai quhej Begatar Kozeli. Safeti, kur ishte profesor në Liceun e Korçës, e mori Begatarin nga fshati Kozel dhe e mbajti në shtëpi, e çoi në Lice ku mësonte, ndërsa nëna i preu një palë rroba të reja dhe kujdeset për të si për fëmijën e saj. Gjatë luftës ai doli partizan dhe u bë ushtarak i lartë.

A jua diti ky person ndihmën e dhënë nga familja juaj?

Fatkeqësisht jo. Pra, ky ushtarak, doli para skenës në atë mbledhje, e dalloj nënën veshur me të zeza dhe i drejtoi gishtin. Ajo e pa gishtin drejtuar nga ajo dhe menjëherë i koka për të mos rënë në sy. Begatori thirri një nga njerëzit e Sigurimit të Shtetit dhe i tha: "Ajo grua është reaksionare, të nxirret menjëherë nga salla, se nuk fillon mbledhja pa dalë ajo". Nëna ime është nga një familje e madhe patriote. I ati isaj, Ramiz Lubonja ishte vrarë në vitin 1912, sepse luftonte kundër pushtuesve osmanë në çetën e Sali Butkës, ndërsa e ëma e saj pui helmin, pasi nuk e donte jetën pas vrasjes së Ramizit, duke e lënë nënën jetime gati një vjeçe e gjysmë. Pra, pati një jetë fatkeqe, që i vazhdoi edhe pas vrasjes së të shoqit, Safetit. Pra, kësaj gruaje patriote, intelektuale e bujare, i drejtohej gishti?!

Ç'ndodhi aty me nënën tuaj?

Nga ajo që ndodhi aty u shqetësuan edhe gratë e lagjes, sidomos e shoqja e Cen Kazazit, që tha se do të dilnin të gjitha si grup dhe në të vërtetë dolën nga salla, si në ato tragjeditë e lashta, një rresht grash që iknin nga skena, për të mos e lënë vetëm nënën. Ajo më tregonte më pas: "Në atë moment u puqën sytë e mi me sytë e tij. Dallova jo një urrëjtje për mua, se s'kishte pse ta kishte, por unë pashë një gjë tjetër, ai e bënte këtë gjë për t'i treguar pushtetit sesi e bënte ai luftën e klavave. Dhe vërtet ai u gradua më pas, por edhe e pësoi si shumë të tjerë nga lufta brenda llojit". Një ngjarje tronditëse, përveç hallëve të tjera të dhimbshme, sidokoftë ajo na rriti me vuarjet dhe ne nuk humbëm.

A jua injektoi nëna juaj ndonjëherë urrëjtjen ndaj atyre njerëzve që ju kishin bërë keq?

Absolutisht jo. Madje, as nuk na thoshte gjëra të tilla, sepse nuk donte të na dëmtonte dhe hakmarrjen të mos



e kishim brenda vetes.

Si dhe ku u shkolluat ju?

Në vazhdom shkollën e mesme pedagogjike, punova arsimtar për disa vjet në rrethin e Fierit dhe të Krujës. Në këtë kohë, në një moment të zigzageve të luftës së klasave, të zbutjes së saj, varur nga marrëdhëniet e Shqipërisë me botën, na u dha mundësia që të ndiqeshin studimet universitare me korrespondencë. Unë kreuva studimet për Filologji dhe u emërova mësues Letërsie në gjimnazin e Krujës. Isha një mësues korrekt, që e bëja me pasion mësuesinë, më domin nxënësit dhe krusanet.

A patët ndonjë peripeci në kohën që ishit mësues në Krujë?

Këtu desha të ndalem dhe po ju rrëfej edhe një ngjarje nga kjo kohë. Sullën në Krujë me qarkullim kuadrosh Masar Begteshin, që kishte punuar në Komitetin Qendror të Partisë, e prunë si drejtor të Shtëpisë së Kulturës. Në prag të festës së Krujës, 22 shtatorit, ai thirri në mbledhje ata që merrshin me kulturën e qytetit, bie fjala me këngët, vallet etj. Më thirri edhe mua që përgatisja çdo vit nxënësit për recitime dhe më tha: "Ti do të recitosh 'Epopenë e Ballit Kombëtar' të Shefqet Musarait". Unë iu përgjigja se mësuesi nuk reciton nëpër festa, por përgatit nxënësit dhe se ky ishte një provokim nga ana e tij. Siç dukej, ishte parapërgatitur

terreni.

Ç'ndodhi më pas?

Masari përpiloi denoncimin se unë nuk kisha pranuar të recitoja "Epopenë e Ballit Kombëtar", sepse isha i biri i Safet Butkës etj., kështu u pre fletarresti për mua nga Dega e Brendshme, e cila do ta bënte arrestimin në mënyrë demonstrative në një klasë të maturës, ku jepja mësim, në mënyrë që të ngjallnin frikë te nxënësit dhe te familjet krutane. Drejtori i gjimnazit, Stefan Bulo, kundërshtoi që unë të arrestohesha në shkollë, kur kjo mund të bëhej jashtë ambienteve të saj. Për këtë shkak ai shkoi në Komitetin e Partisë, ku sekretar i parë ishte Piro Kondi. Stefani, drejtor me integritet dhe me kurajë, ishte nga Zagoria, nga ishte edhe Piro Kondi dhe familjet e tyre ishin miq e të afërt. Ai i kërkoi Piro Kondit, që unë të mos arrestohesha në orën e mësimit në mes të nxënësve dhe i tregoi të vërtetën e asaj ngjarjeje. "Po ç'njeri është ky", e pyeti Piro? Drejtori i tha se "është mësuesi më i mirë i shkollës". "Po i kujt është?", vazhdoi sekretari i parë? "I biri i Safet Butkës", iu përgjigj drejtori. "Ash-tu..., unë kam qenë nxënësi i Safet Butkës në Gjirokastër. Ishte drejtor, mësues dhe patriot i mirë. Ai e vrau veten për të mos luftuar kundër nesh (thënë në intimitet). Uo vetëm që nuk do arrestohet në sy të nxënësve, por s'do të arrestohet fare. Le të merret ndonjë masë tjetër", urdhëroi Piro Kondi.

Dhe u zbatua urdhri i tij?

Po, patjetër: Në të vërtetë, nuk më arrestuan, por më çuan mësues në një fshat të Krujës. Derven i thonë. Pas disa vitesh, më pushuan nga puna, si mjaft të tjerë me "njolla në biografi", se dolën kuadro të rinj besnikë të partisë. Unë u ktheva në Tiranë dhe punova si punëtor. Më pas u fut në shkollën e mesme artistike "Jordan Misja", që të merrja një profesion tjetër. Arrita të vendosha në fabrikën e këpucëve si piktor. Kështu vazhdoi një jetë pak a shumë më e qetë. Në fabrikën e këpucëve u njoha me mjekën Merjeme Pasmaçi, që kishte ardhur atje për një studim qytetare beratase. Kështu, ngritëm familjen, por na goditi lufta sërisht e klasave.

(vijon nesër)

dhe është çmuar ky akt edhe nga kundërshtarët, si një personalitet që e vrau veten, që të mos derdhej gjak shqiptari. Ai është dekoruar me urdhrin më të lartë, "Urdhri i Flamurit Kombëtar" dhe me urdhrin "Nder i Kombit".

Pasi rrëfym në mënyrë të përmblodhur jetën dhe veprimtarinë e gjyshit dhe babait tuaj, kemi mbërritur te ju...?

Unë kam lindur më 2 dhjetor 1938, në Tiranë. Asokohe im atë, Safeti, mblodhi miqtë e tij, mes tyre edhe Dr. Bashon, bashkëstudent në Austri dhe themelues i spitalit dhe të maternitetit në Tiranë. Madje Dr. Bashoja ma ka vënë edhe emrin. E ka përshkuar Safeti në një ditar të vogël, këtë ditëlindje në shtëpinë tonë në Tiranë. Jeta ime filloi aty më vonë u trazua, sepse vetë jeta e familjes sonë u trazua.

Konkretisht, çfarë ndodhi me familjen tuaj me ardhjen e komunistëve në pushtet në dhjetorin e 1944-ës?

Pas Luftës së Dytë Botërore dhe marrjes së pushtetit nga komunistët, i pari veprim ndaj familjes Butka ishte sekuestrimi i të gjithë pasurisë së Safet Butkës si "armik i popullit". E para

familje që u internua në kampin e përqendrimit të Krujës në vitin 1945 ishte familja Butka. Ka pasur dy lloje internimesh: në kampe përqendrimit të rrethuar me tela me gjemba, me roje të armatosura si ato të nazifashizmit siç ka qenë kampi i Krujës, i Kamzës dhe i Tepele- nës dhe mandej kampe të internimeve në tërë Shqipërinë. Nuk po zgjatëm në këto vuajtje, pasi pjesa më e madhe e shqiptarëve i ka hequr; në fund të fundit vuajtja është një fatkeqësi, nuk është ndonjë meritë. Natyrisht, ajo që na u gjend pranë në fatkeqësi ishte nëna ime, Hatixheja, ajo na rriti me sakrificë.

Prej sa vetash përbëhej familja juaj në atë kohë?

Isim katër fëmijë jetimë: dy vëllezërit e mi të mëdhenj, Iljazi dhe Saliu, unë më i vogël dhe motra Tefta. Ajo na ushqeu me dashurinë për Safetin, pavarësisht se ç'thuhej nga historiografia komuniste. Koçi Xoxe thoshte se: Safeti, duke vrarë veten, na i kurseu neve një plumb ballit". (Vite më vonë, kur unë u përfshiva në Lëvizjen Demokratike, u përsëriti kjo insinuatë të "Zëri i Popullit", ku u shkrua: "Uran Butka do të vrasë veten si i ati". Kur u ktheva nga

United Nations Development Programme

VACANCY ANNOUNCEMENT

The UNDP office in Albania is looking for a qualified candidate who could fill the following vacancy.

Post Title: National Expert on Public Service Delivery

Duty station: Tirana

Duration of Assignment: 150 days for a period of 11 months

Type of Contract: Individual Contract

Educational Background: Degree in public administration, law, economics, development studies or other relevant fields

Work Experience: A minimum of 7 years progressively, responsible and relevant professional working experience in the area of service delivery at local level, more specifically in: Designing and organizing public services, based on strategies, development policies and needs; Proposing strategic plans to ensure the improvement and development of services at local level; Engaging in assessment activities in view of public service provision; Proposing recommendations for improving public services by evaluating various options of partnerships; Proven track record in provision of technical assistance in the area of reforms in public services at local level, institutional development, analyses of service delivery framework, standards definition and/or criteria setting related to service provision at local level; Prior experience as executive in public services would be an asset;

Demonstrated understanding of Albania's local governance system. Experience in integrated governance programming / institutional development.

Tentative Starting Date: 01 Feb 2019

Deadline for Application: 24 Jan 2019

Job Description:

Available at UNDP site: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>

Interested and qualified candidates are requested to submit their application online only (available at <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>). Incomplete applications will not be considered. Only short-listed candidates will be notified.



STUDIMI

Shpata që iu dhurua Skënderbeut në Krishtlindjen e vitit 1466

Muzeu Historik Kombëtar ka bërë të mundur botimin e revistës shkencore Studime Muzeologjike Nr. 8, e cila është botuar në kuadër të vitit mbarekombëtar të Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Revista "Studime Muzeologjike" është organ i Muzeut Historik Kombëtar. Qëllimi kryesor i kësaj reviste shkencore është të stimulojë debatin rreth vlerave të trashëgimisë kulturore shqiptare. Nëpërmjet revistës "Studime Muzeologjike", Muzeu Historik Kombëtar nxit dhe inkurajon veprimtarinë kërkimore-shkencore në fushën e muzeologjisë, historisë, antropologjisë, konservimit dhe restaurimit të objekteve muzeore. Prej revistës, shkëpusim një prej studimeve.

Dr. Dorian Koçi*

Skënderbeu nuk do të mund të ringjallej i vetëm pa simbolet e tij, që kishin shënjuar historinë dhe shkëlqyer në epokën e vet, ndaj për këtë arsye së bashku me monumentet dhe portretizimet letrare të De Radës dhe Naim Frashërit do të gjejmë dhe përpjekjet e para për të zbuluar flamurin dhe përshkruar armët e tij. Informacionet e para në këtë drejtim i jep Konica në faqet e gazetës së vet "Albania", ku publikon për herë të parë flamurin e Kastriotëve dhe informacionin për armët e Skënderbeut. Si një studiues skrupuloz, Konica, i cili e vëzhgoi në fillim të shekullit XX në trupin e njëres prej shpatave shiheshin ende njolla gjaku, çka mund të ishte e vërtetë, por nëse do të marrim parasysh dhe anën tjetër të personalitetit të Konicës, si pishtar i zgjimit të ndërgjegjes kombëtare mund të ishte dhe një informacion shtesë për të krijuar emocion dhe afekcion ndër shqiptarët, që ende ishin nën zgjedhën otomane. Në fakt të ky tipar i fundit i arsyes së përse Konica mund të ketë shtuar faktin se ende në shpatë kishte njolla gjaku, qëndron dhe një funksion tjetër i armëve të Skënderbeut gjatë Rilindjes Kombëtare, por dhe në vazhdimësinë e shtetit shqiptar. Kështu, në vigjilje të 20-vjetorit të pavarësisë gazetë "Besa" në Tiranë, e krijuar dhe e sponsorizuar nga Mbreti Zog I, do të japë një informacion të detajuar të vendit, mënyrës dhe rrugëve sesi janë gjendur në Vjenë, armët e heroit tonë kombëtar. Duke iu referuar gazetës "Besa" (3 mars 1932) mësojmë këto të dhëna për Armët e Skënderbeut: Koleksionuesi i objekteve të Skënderbeut ishte Arqiduka i Tirolit Ferdinand (1529-1595), i biri i perandorit austriak Ferdinand I (1503-1564) dhe vëllai i perandorit Maksimilian II.



Këshilltar i arqidukës Ferdinand për mbledhjen e këtyre objekteve, ishte sekretari i tij privat Jacob Schrenckh von Notzing (Jakob Shrenk von Nociing). Ai koleksiononte veshje prej hekuri dhe armë të princërve të shquar, si dhe të prijësve të ushtrive, të cilat i ruante në kështjellën e tij në Ambras. Objektet e Skënderbeut përmenden për herë të parë në një letër të datës 15 tetor të vitit 1578, në të cilën duket i Urbinos Marius Sforca, i shkruante arqidukës Ferdinand, se do t'i dërgonte këtyrë fundit armët e Skënderbeut. Më 15 maj 1579 arqiduka i Tirolit, Ferdinand, i shkruan dukës së Urbinos Marius Sforces, duke e falënderuar për armët e Skënderbeut si dhe për të tjerat, të cilat mund t'i binin atij në dorë. Këto objekte përmenden për herë të dytë në letërën e dukës von Arescot (duka von Arescot) më 25 korrik 1588, e cila flet mbi armët e tjera të Skënderbeut. Objektet e Skënderbeut nuk ishin shënuar në inventarin e vitit 1585. Ndërsa në inventarin e vitit 1593, f. 69, shënohet: "Dy shpata dhe përkrenarja e "Georgen Scanderbegg". Prej këtyre dy shkresave, si dhe inventarit, konstatohet lehtë se përkrenarja dhe dy shpatat e Skënderbeut ranë në dorë të arqidukës Ferdinand, ndërmjet viteve 1588 dhe 1593, përmes ndihmës së dukës Marius Sforca të Urbinos dhe të dukës Arescot. Në sallën XXV Nr. 71 (127), të Muzeut të Arteve të Vjenës, ndodhet përkrenarja "George Skanderbeg". Ajo është ngjyrë e bardhë, me rrafshet të arta dhe ka sipër saj një kokë dhe të artë me dy brinjë. Në një vrimë në majë të përkrenares është vendosur një burgi, e cila paraqet një kokë dhe të fiksur mirë. Kjo përbëhet prej dy pjesëve: një pjesë bakri dhe pjesa tjetër sipër është me një copë metali,

Armët e heroit dhe ndërgjegjia kombëtare e shqiptarëve

buzët e së cilës janë të zbuluara në ar. Syve të dhisë sipër përkrenares, i mungojnë gurët dhe akoma i duket vendi bosh, i cili të jep të kuptosh se brenda kanë qenë vendosur gurët. Në mesin e përkrenares është vendosur një rreth prej bakri me një gjatësi prej 65 dhe në këtë rreth janë shkruar këto shkronja: I. N. P. E. RA. TO. BE. BT. Ky shkrim, që është shumë i vështirë për ta kuptuar se çfarë thotë, deri tani e kanë deshifruar kështu: "Jesus Nazareus Principi Emathiae. Regi Albaniae. Terrori Osmanorum. Regi Epiri. Benedictat". Poshtë buzës së përkrenares janë vënë 9 copa të mëdha dhe këto janë të lidhura me një rrip lëkure me bojë hiri. Peshë e të gjithë përkrenares është 3000 gr. Kjo përkrenare është një ujum, i vetmi dhe i veçant, që gjën-

det në muze. Ajo i përket artit të punimit të metalit në stilin gotik të vonshëm. Kjo përkrenare në pikëpamjen estetike, është një vepër e mrekullueshme dhe i ka hije vetëm një burri të fuqishëm, të fortë dhe me vullnet të hekurt. Sado që kjo përkrenare ka elemente orientale, mendohet se është punuar prej një artisti venecian. Më poshtë informacioni i gazetës "Besa" vazhdon për shpatat e Heroit Kombëtar. Në Muzeun e Arteve të Vjenës ka dy shpata të Skënderbeut. Njëra shpatë është me dorezë kadifeje, në të cilën shënohet emri i Skënderbeut dhe është e gjatë 88.5 cm dhe e gjerë 5.7 cm, me dy tehe, me një formë të drejtë dhe me një majë të kthyer; që përmban disa shkronja latine, ku lexohen këto fjalë: "Heroi i Perëndisë, Iskander Beg". Doreza

është prej druri, e mbështjellë me lëkurë. Peshë e kësaj shpate është 1300 gr. dhe bashkë me këllëfin, është 1900 gr.

Shpata tjetër është me dorezë lëkure shagren, ka në anët e jashtëme katër arabeska të thella, tri rripa për hijeshi. Shpata është e përkulur në formë harku, gjatësia e saj është 121 cm dhe doreza është e zbuluar me ar dhe me lëkurë. Peshë e gjithë shpatës është 3, 2 kg. Kjo formë me ornamente tregon se ajo është bërë në gjysmën e parë të shekullit XV.


Revista "Albania", në numrin 8, të vitit I të botimit të saj, ka shkruar për armët e Skënderbeut, që ndodhen në Muzeun Perandorak të Vjenës. Përveç përkrenares dhe shpatës, që përshkruan artikulli, në këtë muze ndodhet edhe një shpatë tjetër, që mendohet se i përkiste Skënderbeut. Kjo shpatë është vendosur në sallën Karli V (salla XXVII), në numrin 345. Doreza është punim turk. Tehu është i dekoruar me zbulurime dhe mbishkrime. Mbishkrimi nuk është i saktë. Ai ka gabime. Ja ky është teksti: "Libehadour - Oullah Iskanderbeg", që do të thotë: "Mbrotjtësit të perëndisë, Skënderbeut".


Doreza dhe këllëfi nuk janë të njëkohshme me teahun. Ato janë punuar pas vitit 1466 e janë ndryshuar, pas vdekjes së Skënderbeut. Në inventarin e pikturave të sekretarit privat Schrenckh (Shrenk), e titulluar "Armamentarium heroicum" të vitit 1601, është tabloja XVI, Skënderbeu me përkrenare me Nr. 71 (127), sipas këtij përshkrimi: Në një kornizë me ornamente të shumta, rri në këmbë në profil Skënderbeu, duke kthyer kokën dhe mjekrën e gjatë nga krahu i majtë. Ai është i veshur me një pallto të gjatë me astar lëkure dhe ajo mbërthehet në gjoks nga shirita. Në krahuin e djathtë mban lart shpatën e zhveshur Nr. 345 (550), ndërsa poshtë në tokë, afër këmbës, qëndron përkrenarja Nr. 71 (127). Në kokë Skënderbeu mban një beretë. Objektet, që janë pasqyruar në këtë pikturë, i ngjajnë shumë origjinaleve që ndodhen në Muzeun e Artit Historik të Vjenës. Duket qartë se këto dy objekte janë njohur në vitin 1601, si të Skënderbeut.

Historiani Kristo Frashëri saktëson shume vite më vonë se gazeta Besa në librin e vet "Historia e Skënderbeut" dhe cila nga shpatat përdore në sheshin e betejave dhe cila për akte ceremoniale.

SHPATA E LUFTËS

Sipas Frashërit, ndër dy shpatat, ka mundësi që Skënderbeu në fushën e betejës të mos përdorte atë me trup të drejtë, por pallën me trup të harkuar (siç nënkuptohet nga Dh. Frëngu), për arsye se e para ishte e shkurtër për shtatin e tij gjatë, kurse me pallën, të cilën e kishte në përdorim ushtria osmane, ai është familjarizuar më





teper se me te paren. Ketyre mund t'u shtohet dhe nje arsye tjetere: me te paren luftetari e kishte me te lehte ta godiste kundershtarin horizontalisht, kurse me te dyten kishte perfitim, sidomos kur ishte trupmadh, ta ngsjesonte me lehte armikun me nje te rrene te fuqishme vertikalisht. E njejta gjë mund te thuhet dhe me perkrenaren, e cila nuk duhet te ketë qene komode ne fushen e betejes. Përfundimisht, mund te thuhet se si perkrenarja ashtu edhe shpata me trup te drejte i kanë shërbyer Skenderbeut. Kjo e dyta te jetë shpata që Papa Pali II i dhuroi Heroit, natën e Krishtlindjeve te vitit 1466.

Nuk ka dyshim se objekti me te interesant nga armët e Heroit tonë Kombëtar mbetet perkrenarja me simbolin e saj kreyt te veçantë në krye, kokën e dhisë. Sipas Frashërit se çfarë ajo simbolizon mbi perkrenaren e Skenderbeut, është vështirë te shpjegohet me saktësi. Mund te shpjegohet me kultin e dhisë së egër, simbolin e zanave shqiptare, te cilat jetojnë, sipas legjendës, edhe sot në bjeshkët e larta, përfshirë edhe në atë të Gjelagjoshit, mali që qëndron mbi krye të Qidhnës së Dibrës. Mirëpo kulti i dhisë së egër sigurisht që ka një shtrirje me te gjerë në mitologjinë ballkanike, duke datuar që në kultin e Zeusit, ku ai i hedhur nga Olimpi nga e ëma e vet, Gjea për t'i shpëtuar frikës paranojake te atit te vetë Kronit që gëlltiste çdo qenie që lindte, bie në Kretë dhe ushqehet nga një dhi e quajtur Amaltea. Ka shenja që tregojnë se kulti i dhisë së egër është shumë i lashtë.

Është tashmë një dëshmi e njohur nëpërmjet Plutarikut se Pirro i Epirit mbante një kokë dhe te ngjashme në perkrenaren e vet, çka mund te mendohet për një kult te mireformuar në viset epirote ilirike. Gjatë gjithë jetës së vet, qysh prej kthimit te tij në viset atërore, Skenderbeu ndihet shumë krenar ndaj trashëgimisë epirote-maqedonase te territoreve te veta, fakt që dëshmohet dhe në letërnën e vet dërguar Princit te Tarantit në 1461 ku nënvizon origjinën epirote

te popullsisë arbë. Një dëshmi tjetër është vepra e Barletit ku vazdimisht përforcohet origjina epirote e trojeve dhe popullsisë arbë. "Njerëzit kur vështronin atë rini luftarake dhe kur shikonin atë lule burrash rreth Skenderbeut, nuk u dukej aq çudi që fuqitë e Muratit ishin thyer prej shqiptarëve. Me te vërtetë ishin kthyer atëherë përsëri shkëlqimi i lashtë i Maqedonisë dhe dukej se kishin ardhur prapë tamam, siç ishin dikur, kohët tanimë te harruara të Aleksandrit dhe të Pirros". Mesa duket kjo krenari e trashëguar nga antikiteti që u rigjet sërisht gjatë Rilindjes Kombëtare dhe u rishfaq me dukshëm në kohën e shtetformimit shqiptar shërbeu për përforcimin e identitetit kombëtar te shqiptarëve, ku

armët e Skenderbeut luajtën një rol te veçantë si objekte krenarie dhe dëshmuese te një formacioni politik te suksesshëm te shqiptarëve në mesjetë. Kjo ka qene dhe një nga arsyet që me porosi te qeverisë shqiptare te paraluftës, një kopje identike e perkrenares së Skenderbeut, punuar me 1937 nga një mjeshtrë i talentuar austriak u ekspozua në Muzeun Historik te Tiranës. Me iniciativën e Dr. Karl Paç si edhe te mjaft intelektualëve te kohës u ngrit një sallë e veçantë, kushtuar Heroit Kombëtar te shqiptarëve Gjergj Kastriotit-Skenderbeut. Ata i kërkuan Ministrisë së Arsimit te caktonte mjetet e duhura financiare për te paguar përgatitjen e kopjeve te objekteve origjinale së Skenderbeut, që gjendeshin në Muzeun

Oborrit Perandorak te Vjenës. Palë parave te mbledhura me këtë rast kopja e shpatës dhe kopja e perkrenares së Skenderbeut u ekspozuan në muze. Ambicia e Dr. Paç nuk përfundoi me kaq. Ai i shkroi Akademisë së Skulpturës te Muzeut te Vjenës për te mundësuar një kopje te bustit te Gjergj Kastriotit-Skenderbeut. Në pavijonin e mesjetës te Muzeut Historik Kombëtar qëndresa e shqiptarëve ndaj pushtimit osman pasqyrohet me anën e objekteve, fotografive dhe dokumenteve te kohës. Nëpërmjet hartave, gravurave, si edhe mjaft botimeve origjinale vizitorët njihen me Heroin tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotin-Skenderbeun, i cili simbolizon luftën e shqiptarëve kundër pushtimit osman. Skenderbeu është përfaqësuesi me i shquar i elitës drejtuese shqiptare, sepse me nismën e tij u realizua Besëlidhja e Lezhës, që është i pari bashkim politik dhe ushtarak i shqiptarëve. Figura e Gjergj Kastriotit ka qene në qendër te vëmendjes edhe te opinionit publik europian. Atij i është kushtuar literaturë e shumëllojte dhe shumëgjuhëshe. Shembulli i Skenderbeut ka qene burim frymëzimi për mobilizimin e popujve në luftën kundër pushtimit osman.

PERIUDHA E SKENDERBEUT NË MHK
Përsa u përket objekteve origjinale Muzeu Historik Kombëtar disponon dy kambana. Një kambanë është gjetur në kishën e Shën Kollit në Shelcan, në krahinën malore te Shpatit, në rrethin e Elbasanit. Në pjesën e pasme te kambanës është gdhendur me numra romakë mbishkrimi ÇÇLV që korrespondon me vitin 1455. Në pjesën e përparme te kambanës është gdhendur një skenë e veçantë, në te cilën paraqitet nëna e Shën Mërisë, Shën Ana e ulur në fron dhe në duar mban dy flamuj te cilët përfundojnë me nga një kryq. Në prehër mban Shën Mërinë. Ndërsa në prehrin e Shën Mërisë është Krishti fëmijë. Kambana tjetër është gjetur në kishën e Karpenit

te Kavajës. Kambana daton në vitin 1465. Mbi te gjendet një mbishkrim në latinisht: THHS MÇÇLXV që korrespondon me vitin 1564. Një vend te dukshëm në pavijon zënë kopja e shpatës dhe e perkrenares së Gjergj Kastriotit Skenderbeut, te cilat janë realizuar sipas originalit që gjendet në Muzeun Perandorak te Vjenës. Kopja e shpatës së Gjergj Kastriotit është punuar në vitin 1981. Shpata është prej bakri, punuar me tekniken artizanale te rrahjes. Kopja e perkrenares së Gjergj Kastriotit është punuar në vitin 1981 nga argendarët R. Hoti dhe J. Devole. Në pjesën kulmore te perkrenares është vendosur një kokë dhe e gdhendur. Perkrenarja është prej bakri. Nga brenda është veshur me lëkurë, që del paksa mbi ballë. Ajo rrethohet prej një rripi lëkure, te zburkuroar me gjashtë trëndafila te praruar. Në këndin e gjetjeve te reja te Muzeut Historik Kombëtar ka disa objekte që lidhen me figurën e Gjergj Kastriotit Skenderbeut. Ndër to mund te veçonim një portret te gëndisur te Skenderbeut, i cili është punuar nga Qamil Xhelal Shitina kur ka qene i burgosur nga Ahmet Zogu, në vitin 1926. Objekt interesant është edhe një karrige me stemën e Skenderbeut, e cila është e gdhendur në mënyrë artizanale. Në pjesën mbështetëse ka te gdhendur portretin e Skenderbeut. Karrigia i është dhuruar Muzeut Historik Kombëtar nga Osman Dervishi me banim në Sidnej te Australisë. Karrigia është blerë në Romë dhe e kanë shpënë në Ambasadën e Shqipërisë, ku ja kanë dorëzuar ambasadorit Z. M. Musalia. Memoria kolektive historike është një nga mjetet që sendërtton fuqishëm identitetin e një popullsie dhe në rastin e etnisë shqiptare, kjo kujtesë kolektive kombëtare shërbeu si një mjet bashkues për ngjizjen e identitetit kombëtar.

***Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar (titujt janë te redaksisë)**

KOSOVA, NË BERLINALE ME FILMIN "NË MES"

Festivali Ndërkombëtar i Filmit Berlinale ka njoftuar mes te tjerash për pjesëmarrjen e filmit "Në mes" te autorit Samir Karahoda në garën ndërkombëtare te filmave te shkurtë "Berlinale Shorts". Kjo është hera e parë që një film nga Kosova pranohet në garën e Berlinales, që njihet si një nga festivalet me prestigjioze në botë. Filmi trajton dy tema paralelisht; fenomenin e ndërimit te shtëpive te njëta dhe migrimin, e cila veçmas theksohet nëpër këto familje. Nëpërmjet personazheve, portretizojnë marrëdhënien dhe solidaritetin në mes vëllezërve, sakrificën dhe vendosmërinë e prindërve për te mbajtur harmoninë brenda familjes, kuptimin dhe rëndësinë e shtëpisë dhe shpresës në mes



kthimit apo jo në vendlindje. Autori i filmit, Samir Karahoda është shprehur i lumtur që filmi i tij debutues si regjisor është vlerësuar nga ky festival pres-

tigjioz: "Nuk e di si ta përshkruaj ndjenjën dhe gëzimin për vlerësimin e filmit nga një festivali siç është Berlinaleja, sidomos kur bëhet fjalë për film debutues. Përzemërisht dua te falënderoj secilin protagonist pa te cilët ky film nuk do te ishte i mundur si dhe ekipin, te cilët u përkushtuan dhe kontribuan me zemër në formimin e kësaj vepre", theksoi autori Karahoda. "Në mes" është inspiruar nga projekti fotografik "Vëllezërit Kosovare" në te cilin Karahoda ka punuar në vitin 2011. Filmi është prodhim autentik i Kosovës, si me mbështetje ashtu edhe në produksion. Producenti i filmit Eroll Bilibani theksoi që ky fakt edhe njëherë dëshmon për kapacitetet kreative te kinematografisë Kosovare: "Te jesh pjesë e një projekti kaq kreativ dhe te punosh me një ekip kaq profesional është me te vërtet

nder dhe privilegj. Edhe pse filmi në fazën fillestare ishte paraparë në formë eksperimentale. Samiri përmes gjuhës filmike me mjeshtri ka arritur ta pasqyrojë kontekstin antropologjik, shoqëror dhe arkitekturale te një fenomeni te përhapur në Kosovë", theksoi producenti Bilibani. Filmi është prodhim i "SK Pictures", i mbështetur nga Qendra Kinematografike e Kosovës, Banka për Biznes, Komuna e Prizrenit, Komuna e Prishtinës dhe "DokuFest". Regjia dhe drejtori i fotografisë: Samir Karahoda, Producent: Eroll Bilibani, Montazhi: Enis Saraci, Dizajneri Zëri: Memli Kelendi, Xhirues Zëri: Gëzim Rama dhe Dizajneri Grafike: Nita Salihu Hoxha. Premiera e filmit në Berlinale do te jetë me 12 shkurt!

Opinion

i Ditës

Tepsi, timon dhe kadri

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... edhe ato ishin duke mbaruar. Megjithatë, u bënë shumë gjëra të mira. Mbi gjysmë miliardë euro iu dhanë qindra e qindra kompanive, ku shteti kishte hyrë borxh (shumica e parave u gjetën duke rritur borxhin publik, pra borxhin e shqiptarëve). Por të paktën u shlye një pjesë e mirë e një borxhi, që po paralizonte sipërmarrjen private aq fort të lidhur me shtetin.

Nga ana tjetër, sistemi energjetik i vendit, gati në kolaps, u arrit të shpëtohej dhe të nisnin sërish investimet. Por, përmirësimi i nivelit të humbjeve jo-teknike (pra vjedhjeve) nga një disiplinë spartane, duke treguar edhe dyert e burgut, solli varfërimin e mëtejshëm të dhjetëra mijëra familjeve të varfra që nuk paguanin energjinë elektrike dhe me paratë e kursyera nga ky mospagim, ia dilnin të jetonin disi më pak varfër. Më 1 janar 2014, pjesa socialiste e tepsisë solli sistemin në rritje të taksave, duke hequr taksën e sheshtë. Një dështim i plotë, edhe pse deri tani vijon të shitet si sukses. Edhe pse taksa mbi fitimin u rrit me 50 për qind, mesatarja e rritjes së të ardhurave nga kjo taksë në pesë vitet 2014-2017 nuk i kalon 8 për qind! Rritja e ndjeshme e kësaj takse solli pakësimin e interesit të investuesve të huaj strategjikë për të investuar bindshëm tek ne. Një gjigant amerikano-turk i tekstilëve që u kishte vënë syrin mbeturinave të ish-kombinatit të tekstilëve të Beratit, pasi humbi disa muaj në vitin 2013 duke thurur plane e bërë kontakte, u largua në qershor 2014, pa investuar. Në këmbim, u vendos në Maqedoni, ku punësoi 6 mijë punonjës.

Me gjithë dështimet një pas një dhe largimet e investuesve seriozë që po mendonin të vendoseshin tek ne, të tërhequr nga taksa e sheshtë dhe kosto e lirë e krahut të punës, socialistët tanë nuk zunë mend. I ndihmuar dy investimet gjigante të nisura përpara se sa



ata të vinin në pushtet, TAP dhe hidrocentralet e Devollit, për të deklaruar çdo vit në periudhën 2014-2018 investime të huaja në nivele rreth 1 miliardë dollarë në vit. Zhvillimin spontan të bujqësisë dhe turizmit (thjesht nga avantazhet krahasuese të tokës sonë dhe bukurive të saj) dhe mungesën e një bumi (rritjeje të fortë) të mirëfilltë të tyre nga mbështetja e duhur shtetërore, socialistët tanë e justifikuan me garuzdembajtësin e dytë të tepsisë. Ai i paskësh pasur të gjitha fajet. Në qershor 2017, drejtuesi i sotëm i qeverisë, gjatë fushatës zgjedhore, me veshje, gjeste dhe fjalë të pazakonta për politikën e 26 viteve deri atëherë, arriti të ng-

jallte një shpresë jo të paktë tek shumë njerëz ("ky që vishet, flet e sillet kështu, duhet të jetë krejt ndryshe nga horrat e deritan-ishëm!"). Shpresë se me timonin vetëm do të shndërronte shumë gjëra për mirë. Shkurt, do ia dilte të bënte shtet dhe të mbante shumicën e shqiptarëve në vendin e tyre. Ndoshta edhe vetë e besonte këtë.

Njerëzit ia besuan këtë përgjegjësi të jashtëzakonshme, shpresën e tyre. Mirëpo mes dëshirave të mira dhe realizimit të tyre është shpesh në mes një det i tërë. E ndjeu këtë peshë dhe provoi një muaj më vonë, duke siluruar të gjithë drejtorët e hipotekave, apo më pas, ata të spitaleve publike, për

të shkundur një administratë përtace, arrogante dhe hajdute. Ishte një fillim i mbarë, por që nuk pati vijimësi. Provoi më tej populizmin e skajshëm të qeverisjes me qytetarët, nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes. Bëri të lumtur qindra qytetarë dhe akoma dhe më ankues e të zhgënjyer me dhjetëra mijëra të tjerë, që aplikonin pranë Bashkëqeverisjes dhe nuk gjenin drejtësinë që kërkonin, nga pamundësia e kësaj strukture që ishte në misionin e pamundur për të dubluar shtetin. Jo se nuk donin të ndihmonin qytetarët koordinatorët e Bashkëqeverisjes, por se një qasje e tillë, populizëm i pastër, nuk mund të prodhonte zgjidhje për të

gjithë, por vetëm shkëlqim të rremë për ata pak hallezgjidhur të lumtur.

Bashkëqeverisja sot mund të prodhojë shifra se të gjithë atyre dhjetëra mijëra qytetarëve që i janë drejtuar u ka dhënë përgjigje, por nuk tregojnë se përqindja e zgjidhjeve që ka mundur të japë në raport me kërkesat, është tejet e vogël dhe trishtuese në këto 14 muaj jetë (tetor 2017 - dhjetor 2018). Heronjtë u lodhën rrugës, jo se nuk donin të ndihmonin, por nuk e kishin atë grusht të fuqishëm të lëviznin malin që z'zbzan, një administratë thellësisht të korruptuar, që nuk u jepte informacionin që u duhej, që në çdo cast i pengonte, tallte, dyzonte, edhe duke i tunduar me favore personale. Kurse kryetimonieri nuk është lodhur ende. Kjo është një gjë shumë e mirë. Ai beson akoma. Ndërroi më shumë se gjysmën e qeverisë përpara gjelit të detit të 31 dhjetorit 2018. Solli deputetin më të ndershëm të parlamentit të ishte zëvendës i tij.

Por shpresa e njerëzve kësajradhe, ndryshe nga koha e çitjanëve nëpër podiume, është shumë më e vakët. Duhet t'i hyjë detit me këmbë në këto dy vite e gjysmë që i kanë mbetur. Dhe ngushëllimi apo vrerderdhja tek kadrintë që nuk e lënë t'u tregojë njerëzve se sa shumë dhe mirë ka bërë, është vetëvrasëse për shanset që kjo hyrje e detit në këmbë të ketë sukses. Kadrijtë, gjysmë-kadrijtë dhe pseudo-kadrijtë nuk i bëjnë punë, sado t'i provokojë. Do i duhet aleancë me të ndershëm të sprovuar, për të bërë varkën e Odisëut. Itaka e shqiptarëve quhet shprehja: "Më shumë se gjysma e qytetarëve të këtij vendi të mos duan të ikin jashtë shtetit nga sytë këmbët!". Sot është tetori 40 për qind. Me studentët tregoi durim dhe përlulesi. I duhet edhe sycëlasi për të afruar rreth vetes dhe motivuar të ndershëm të tërësisht të ndershmit në administratë. Ka shumë të tillë, duhet vetëm t'i gjejë dhe t'u ofrojë zemrën, nëse e ka me tërë mend. Këta tre elementë duhet të jenë vajguri i llambës së tij të Diogjenit, për të gjetur shpresën e humbur të shqiptarëve se vendi i tyre bëhet.

BLUE TOOTH
THASHETHEME
MADE IN
ALBANIA

te rejat
nga jeta
ipave

çdo të shtunë falas me

Opinioni **i** Ditës

Dilemat hamletiane të Brexit

Nga Dr. Jorgji KOTE

(vijon nga faqja 1)

... të mos jesh/të qëndrosh apo të shkosh nga BE-ja (to leave or to remain in the EU) Përgjigja e parë dhe vendimtare pritet të jepet sonte më 15 janar në Dhomën e Ulët të Parlamentit britanik.

Veç kësaj, kaosi "demokratik" që ka shkaktuar 23 qersori 2016 me Brexit në politikën, opinionin publik, median dhe shoqërinë britanike po shoqërohet dhe me shumë dilema të tjera "hamletiane" po aq jetike/sfiduese; në mënyrë të panjohurash dhe rrugë pa krye sidomos për të tashmen dhe të ardhmen e këtij vendi të madh. Qoftë dhe një vështrim kalimthi i katalogut të këtyre dilemave të bind lehtë për këtë lëshim të paparë politik/publik në 100 vitet e fundit në Britanisë së Madhe.

"Brexit të butë apo të ashpër? Me apo pa Brexit? Të zgjatet apo jo periudha kalimtare? Të qëndrojmë në këtë qeveri apo të ikim prej saj? Ta rrezojmë gjithë qeverinë apo vetëm Kryeministren May?"

Të shkojmë në zgjedhje të parakohshme apo të presim deri sa të bëhet Brexit? Brexit laburist apo konservator? Të bëjmë apo të mos bëjmë një referendum të dytë? Apo dhe të tretë, sipas parimit "e treta e vërteta". Por, nëse veprohet kështu, fiton apo humbet besueshmëria të vota e lirë dhe demokracia dhe i hapet rruga anarkisë dhe luftës jociville?"

"Po sikur të dalim pa asnjë marrëveshje? (No deal) Pikërisht kjo e fundit ka shkaktuar alarmin dhe panikun më të madh në Londër dhe në Evropë për rreziqet e shumta për rendin dhe sigurinë, sidomos ndërmjet Irlandës së Veriut si pjesë e Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës që mbetet në BE. Ndaj, Ministri britanik i Mbrojtjes Stephan Barclay ka urdhëruar vënie në gatishmëri të mbi 1.000 policëve dhe 3500 forcave ushtarake për të përballuar çdo të papritur në transport, aeroportet dhe gjëtkë." Nderkohë, krerët e ekonomisë dhe tregtisë britanike kanë paralajmëruar se ky lloj largimi do të ishte me shumë pasoja të rënda për Londrën, sepse është e pamundur që gjërat në biznes të lëvizin aq shpejt si në politikë.

Një Brexit pa marrëveshje do të kishte pasoja të mëdha dhe për vendet anëtare të BE-së. Kështu, meqenëse Britania e Madhe është donatori i dytë më i madh në BE pas Gjermanisë, si kompensim, kjo e fundit do të detyrohej të derdhte në BE 4 miliardë euro më shumë për vitin 2020 dhe në vijim nga 3 miliardë euro më shumë vetëm si pasojë e rivendosijes së kontrolleve doganore.

Kësisoj, Brexit, suksesi i parë i popullitëve në Europë i ngjan " fitoret së Pirros" Po vërtetohet kështu thënia e urtë "hidh një lek futu në valle, fut 100, por nuk del dot fare" Sepse është absurde të bësh



një referendum thjesht ku kërkohet një "Po ose Jo". Me BE apo me Brexit " të rrimë apo të ikim " kur ka me qindra aspekte të koklavitura që kanë të bëjnë me jetën e përditshme dhe që presin përgjigje/analiza shteruese.

Për pasojë janë të pakënaqur me ecurinë e deritanishme, si breksitasit ashtu dhe ata që duan të qëndrojnë në BE. Ditët e fundit edhe 170 rektorët e universiteteve britanike paralajmëruan qeverinë për rreziqet e mëdha që i kanosen për shkak të Brexit.

Këto dukuri e dilema janë të mbarsura me pasoja me katastrofike se tragjeditë shekspiriane; sepse nuk janë të castit por burrojnë nga një sfond historik i veçantë i Britanisë së Madhe; anëtarësimi i saj në BE më 1973 është shoqëruar vazhdimisht me qëndrime hezituese, dyzuese dhe të dyshimta, që kanë synuar kufizimin e rrolit dhe diapazonit të BE-së, si bashkim i madh politik.

Siç ka pohuar tre vjet më parë në një takim ku isha i pranishëm në Bruksel, Këshilltar personal i Përfaqësueses së Lartë të BE-së, ambasadori Colin Sciclun "është shumë e çuditshme që Britania e Madhe i përmbahet ende mentalitetit të një shekulli më parë sipas të cilit, çdo lloj bashkimi politik jashtë " ishullit" është rrezik për mbijetesën e saj!"

Ndërsa sipas shumë analistëve dhe diplomatëve të lartë, Britania e Madhe e koncepton BE-në kryesisht një treg të madh e të lirë ekonomik dhe financiar.

Le të shpjegojmë shkurt për lexuesin e thjeshtë se këto qëndrime kanë zënë fill qysh me Burrin e madh të Shtetit britanik, Winston Çurçill. Ndonëse paralamjëroi i pari në vitin 1946 krijimin e një lloj " Shtete të Bashkuara të Evropës " Çurçill e shihte Britaninë e Madhe jashtë BE-së, vetëm si " mik dhe nxitës "

Edhe pasardhësi i tij, Clement Attlee i tha "Jo" Mont Unionit, ashtu si Macmillan që ishte kundër Bashkimit Ekonomik Evropian në favor të një EFTA-je evropiane, pra një zonë të madhe

të tregtisë së lirë pa tati me dhe dogana.

Në vitin 1975, dy vjet pas anëtarësimit në BE, Kryeministri Harold Wilson kërcënoi BE-në me përsëritjen e negociatave. Mirëpo në Referendumin e zhvilluar më 1975, 67 për qind thanë " PO " dhe Britania e Madhe vijoi në BE.

Për të ardhur në vitet 80, kur Margaret Thatcher u bë kundërshtar e ashpër e masave dhe reformave të BE-së që binin ndesh me interesat e saj ekonomike dhe tregtare. Kulmin e pati me kërkesën e saj emblematike " Më ktheni paratë e mia " (I want my money back) duke kërkuar një sërë rabatesh dhe favorimesh për Britaninë apo me treg " JO " të saj të famshme.

Në vitet 2000, Kryeministri laburist Blair i ndryshoi ndjeshëm qëndrimin britanik në favor të BE-së. Madje ai ishte gati të bënte Referendumin për futjen e Britanisë dhe në Shengen/Zonën Euro. Falë imazhit proeuropian ai mendohej se do të ishte President i Komisionit Evropian. Mirëpo mbështetja e tij pa rezerva dhe e tepruar ndaj Presidentit Bush në ndërhyrjen ushtarake në Irak kundër rrymës kryesore të BE-së ia prishi këtë imazh dhe brenda vendit, duke e detyruar të jepte dorëheqjen.

Pas largimit të tij dhe të Gordon Brown punët filluan të shkojnë keq e më keq ndërmjet Britanisë dhe BE-së. Kryeministri konservator Cameron për interesa të ngushta të forcimit të pozitës së tij në Parti bëri gabimin katastrofal duke shpallur Referendumin për Brexit. Ndonëse BE-ja do tënën se i luajti të gjitha kartat duke i bërë lëshime pa lëshimi, vetëm e vetëm që të mos bëhej ai referendum pa sens për një çështje të tillë aq të ngatërruar që do të kthehej, siç ndodhi në " municion " për popullistët dhe nacionalistët e UKIP. Ndonëse fitorja e Brexit ishte tejte e ngushtë, me vetëm 51,9 për qind, ajo çeli dhe për vende të tjera kapitullin dramatik me emra të frikshëm Frexit, Belxiti, Grexiti etj.

Vetëm se siç pranohet gjerë-

sisht, BE u tregua stoike dhe nuk kundrejti Brexit, duke " qëndisur " me fjalët e Merkel një " marrëveshje vepër arti " Ndaj, BE nuk mund të lëshojnë asnjë fije peri ndaj kërkesave të Kryeministres britanike May, e cila vazhdon të orvatet për të shfrytëzuar çdo lëshim të mundshëm, si " kamerdare shpëtimi " në vorbullën e paparë britanike, tani kur as 100 ditë nuk na ndajnë nga divorci me BE.

Gjithsesi, BE do të jetë e gatshme vetëm për një shtyrje disa mujore të afatit të " divorcit " të 29 Marsit në rastin e rrëzimit të Brexitit në " provimin " parlamentar britanik më 15 janar. Gjithashtu, siç pohojnë në letërën e tyre në fillim të kësaj jave dhe mbi 100 europarlamentarë, BE do të mirëpresë Britaninë e Madhe në BE në rastin e dështimit të Brexit.

Përfundimi madhor me këtë rast është se Brexit është shfaqje e shtrembëruar e demokracisë, edhe pse doli nga vota e shumicës, një minus dhe dëshmi e qartë kundër hyznizimit të kësaj vote, sado e lirë dhe e ndereshme të jetë.

Gjithashtu, dilemat e tipit hamletian të Brexit tregojnë se vërtet që BE-ja ka shumë probleme, zhgënjime dhe mangësi, sidomos në drejtim të frymës së projektit të saj; mirëpo, problemi me euroskeptikët dhe populistët është se ata shohin vetëm krizat dhe deficitet dhe ato vetëm në Bruksel, por jo arrijtjet e shumta, paqen dhe stabilitetin ; ata shohin vetëm kostot dhe humbet por jo përfitimet dhe avantazhet, të këqijat, por jo të mirat, privacionet, por jo liritë dhe privilegjet, minueset, por jo pluset, problemet, por jo mundësitë që ofron BE-ja. Fatkeqësisht më e madhe, siç po duket dhe në Londër, është se euroskeptikët populistë mund të kenë politikanë, por jo politika, ndaj ata nuk kanë dhe në fakt as që mund të ketë alternativë tjetër bindëse më të mirë dhe konkurruese se BE-ja. Ja shihni Farage, Johnson dhe të tjerë liderë euroskeptikë britanikë; sapo fitoi Brexit u larguan menjëherë nga politika, sepse nuk shihnin dhe nuk gjenin dot dalje të vërtetë, por vetëm " entry ", pra hyrje në telashe/probleme të tjera dhe më të mëdha e të papritura. " Ja pse në Britani po rritet përditë numri i njerëzve të thjeshtë që mendojnë se " as BE-ja nuk është problem por as Brexit nuk është zgjidhja e halëve të përditshme të britanikëve, madje " jashtë BE-së mërdhif më shumë se brenda saj "

Dështimi i Brexit padyshim është lajm i mirë për forcat progresive dhe demokratike për një Evropë më të mirë dhe me më shumë " frymë " Fushata e zgjedhjeve për në Parlamentin Evropian është mundësia e parë madhore e artë për të shënuar kthesën dhe fitoren e projektit të reformuar ndaj populizmit, ekstremizmit dhe euroskeptizmit; që në vend të Brexitit dhe " exits " për BE-në të ketë vetëm reformim, thellim dhe zgjerim të mëtejshëm e sa më shpejt edhe drejt Ballkanit Perëndimor dhe Shqipërisë.

HOROSKOPI

DASHI

Dita e sotme nuk do të sjellë shumë ndryshime për ju. Mund të ndiheni sikur jeta ka ndalur dhe se nuk do të ketë asnjë mundësi për ju. Do të ishte mirë që këtë ditë ta shpenzoni duke u relaksuar ose duke konsoliduar atë çfarë keni arritur.

DEMI

Për disa Dema, kjo ditë do të jetë për triumfe personale. Mund të arrihi sukses në lidhjen tuaj të dashurisë, por edhe pasi të bëni një deklaratë rreth vetes përballë publikut. Mos harrori çështjet e përditshme rutinë, përkundrazi, duhet t'i kushtoni shumë vëmendje.

BINJAKET

Shumë Binjakë do ta kalojnë 15 janarin në paqe. Do të mendoni për të ardhmen, ose do të mendoni mënyrën sesi të zgjidhni një mosmarrëveshje afatgjatë. Pak sukses pritet në çështjet personale. Ka gjasë që dikush të shprehë interes ndaj jush.

GAFORJA

Gaforret nuk rekomandohen të rrezikojnë sot. Kjo kështillë vlen për të gjitha fushat e jetës. Do të bënit mirë të vëzhgonit çfarë po ndodh, mendoni rreth saj dhe dilni në një përfundim. Bëni kujdes me shëndetin, zgjidhni një dietë të re.

LUANI

Do të ndiheni shumë mirë emocionalisht. Nëse besoni vërtet tek vetja, përcaktori një qëllim pasi ka gjasë ta arini atë shumë lehtë. Mund të debatooni me një prej familjarëve. Sot nuk është dita e duhur për të eksperimentuar me stili tuaj të veshjes.

VIRGJERESHA

Personat e kësaj shenje do të ndihen krenarë sot. Do të kryeni një akt shumë fisnik, të cilin personat rreth jush do ta vlerësojnë pamasë. Virgjërshat rekomandohet t'u kushtojnë më shumë vëmendje partnerëve.

PESHORJA

Do të mendoni pozitivisht gjatë ditës së sotme. Do të takoni disa miq, me të cilët keni vite pa u parë. Peshorëve që merren me biznes do t'ju buzëqeshë fati. Idetë tuaja të reja do të mbështeten nga shumë persona, përfshirë këtu edhe investitorët.

AKREPI

Mund të mbeteni të pakënaqur për shkak të disa çështjeve gjatë ditës së sotme. Duhet të ndryshoni sjelljen ndaj të afërmeve tuaj. Do të kaloni një mbrëmje të qetë nën praninë e partnerit/partneres suaj.

SHIGJETARI

Shigjetarët duhet të shmangin vendet e mbipoplluara sot, pasi shanset për të marrë ndonjë virus janë të mëdha. Nëse nuk mund të shmangni ndonjë udhëtim apo duhet patjetër të shkoni diku, atëherë tregohuni shumë të kujdesshëm.

BRICJAPI

Disa Bricjapë do të duan privatësi dhe qetësi. Nëse nuk mund ta merrni pushin ditën e sotme, duhet të veprohi vetëm. Në mbrëmje nuk rekomandohet të përfshihen në ndonjë aktivitet sportiv, pasi mund të dëmtoheni.

UJORI

Ujorët mund të befasohen nga disa ndryshime të pakëndshme në sjelljen e partnerit/partneres suaj. Lëri gjërat të rrijnë dhe vetë. Sot prioritet duhet të keni financa. Mos bëni blerje të kota, të cilat mund të vënë në rrezik buxhetin tuaj.

PESHQIT

Do të jetë një ditë shumë e veçantë për ju. Do të përfshihen nëpër aktivitete që u falin vetëm kënaqësi. Dikush do të flassë shumë sinagjerisht me ju. Ka gjasë që personi në fjalë të shndërrohet shumë i afër për ju.

Federata kërkon të ndreqë kaosin e viteve të fundit

Situata skandaloze me licensimet, FSHF takim me klubet

Kaosi i krijuar në sezonet e kaluara, ku skuadra të caktuara nuk janë licencuar dot për në Kupat e Europës, por edhe për kompeticionet e FSHF-së, ka bërë që në institucionin më të lartë të futbollit në Shqipëri, të ndërmerren masa. Kryesuar nga Eduard Gjini, sektori i Licencimeve pranë FSHF, ka zhvilluar takime dyp-

alëshe me përfaqësues të klubeve dhe ekspertëve të kriterëve, për të sqaruar dokumentacionet për pesë kriteret, sportiv, atë infrastrukturor, administrativ, ligjor dhe financiar. "Sektori i Licencimeve në Federatën Shqiptare të Futbollit është duke kryer takime dypalëshe me klubet kandidatë për pjesëmarrje në kompeticionet e UEFA-s dhe FSHF-së për sezonin 2019-2020. Këto takime, ku përfaqësuesit e klubeve

kandidatë takohen me drejtuesin e sektorit të licencimeve dhe ekspertët e kriterëve, bëhet me qëllim për të parë situatën e tyre dhe për t'i asistuar së bashku me ekspertët në plotësimin e dokumentacionit

të kërkuar për të pestë kriteret, duke filluar me kriterin sportiv, atë infrastrukturor, administrativ, ligjor dhe financiar. Procesi i licencimeve për katër kriteret e parë duhet të përmbyllet deri më 28 shkurt 2019, ndërsa për kriterin financiar që është edhe pika më e rëndësishme në dhënie të licencës, duhet të përfundojë brenda datës 31 mars 2019", - lexohet në njoftimin e FSHF-së.

FLET ISH-TRAJNERI

Kapelo: Vetëm Interi mund të rivalizojë Juventusin

Trajneri italian Fabio Kapelo ka dhënë një intervistë të gjatë për Tuttosport duke folur për disa nga çështjet kryesore të futbollit italian, ku mes të tjerash ka komentuar gjendjen e Interit dhe atë të Juventusit. Ai është i bindur se nën menaxhimin e Suning, Inter mund të jetë rivali kryesor me Juventusin. "Inter i Suning? Ka potencial të madh. Presidenti është një njeri inteligjent me iniciativë dhe karizëm të jashtëzakonshëm. Pas lidhjes me Suning, unë mund t'ju siguroj se Interi do të jetë 100% rivali i Juventusit në vitet e ardhshme, dhe jo vetëm në Itali. Marota siguron një hap tjetër në cilësi. Ju do të shihni se Interi, ashtu si Juventusin, do të jetë pjesë e elitës evropiane. Juve? Nuk ka sekrete. Ata e ndërtojnë ekipin në një mënyrë inteligjente, duke u shqetësuar për përmirësimin çdo herë. Gjithmonë mendojmë se çfarë po bën në Itali, por forcën e vërtetë po e tregojnë edhe në Europë, duke shkuar në finalen e Championsit. Aty është një ndeshje dhe e fiton ose e humbet, por gjëja e rëndësishme është të arrish deri në fund. Nuk ka konkurrencë në Itali dhe kjo dallohet lehtë", - u shpreh Kapelo.

Të kuqtë shënojnë të parët, por përmbysen nga kampionët e Kroacisë. Shkurtaj e Çyrbja kënaqin Cungun

Kukësi thyen Karagandin, Dinamo mposht Partizanin

Miqësoret e fundit të kryesuesve në Turqi



Jeton Selimi

Partizani e mbyll me humbje serinë e miqësoreve në tokën turke, teksa është detyruar të gjunjëzohet përpara fuqisë së gjigantëve ballkanas të Dinamos së Zagrebit. Të dy trajnerët e kanë shfrytëzuar këtë miqësore për të testuar lojtarët e tyre. Te formacioni fillestar i të kuqve binte në sy aktivizimi i Dilaver Dukës nga minuta e parë, lojtar ky që ka ardhur pak ditë më parë për të zhvilluar një provë me të kuqtë. Kryeqytetasit e nisnin shumë mirë ndeshjen, ndërsa shënojnë të parët me anë të Jurgen Bardhit, që në minutën e 11-të mposht portierin Livaković. Dinamo e Zagrebit reagon dhe në minutën e 28-të Moro shfrytëzon më së miri një mfishësi të mbrojtës së kuqe, duke thyer Hoxhën në shtyllën e largët. Gega detyrohet të largojë që në pjesën e parë Telushin dhe Dukën për arsye dëmtimi, ndërsa në pjesën e dytë hedh nga minuta e parë Lum Rexhepin, mbrojtësin e ardhur vetëm 24 orë më parë në gjirin e të kuqve. Gjithsesi Dinamo e Zagrebit do të shënojë në



minutën e 52-të golin e avantazhit. Në fakt, është një moment shumë i dyshimtë ky, me lojtarët e Partizanit që protestojnë, sepse sipas tyre topi nuk e kishte kaluar vijën fatale. Më pas nis valsi total i zëvendësimeve. Të kuqtë përpigjen të ndryshojnë diçka, por, pavarësisht një ofensive të mirë në minutat e fundit, miqësorja përfundon me shifrat 2-1, humbja e parë kjo për Partizanin pas dy barazimeve me Sivaspordin dhe Antaliaspordin.

Kukësi ka fituar miqësoren e tretë në fazën përgatitore që po zhvillon në Antalia të Turqisë. Pas humbjes me Bashakshehir dhe barazimit me Rostov, sot ekipi verilindor ka fituar me shifrat 2-0 ndaj Shakhter Karagandi. Trajneri Cungu kishte bërë

disa ndryshime në formacion, duke dekuruar lënie në stol të Rexhinaldos për t'i bërë vend Shkurtajt dhe sulmuesi që iu afrua në janar ekipit gjatë shpejt rrugën e rrjetës, që në minutën e 9-të takimit. Më pas, ai që shënoi golin e dytë ishte Arbër Çyrbja, pak minuta para fundit të pjesës së parë, duke konfirmuar se po kalon një formë të shkëlqyer. Futbollisti kishte shënuar edhe në 2 ndeshjet e mëparshme miqësore, duke u kthyer kështu në protagonistin absolut të fazës përgatitore për skuadrën e tij. Më shifrat 2-0 është mbyllur e gjithë ndeshja duke i dhënë Kukësit një rezultat shumë të mirë për moralin dhe që konfirmon rritjen e skuadrës, e cila është pretendente për të fituar titullin kampion.

SULMUESI KUQEZI

Më në fund në lajm i mirë edhe për Sokol Çikalleshin. Sulmuesi i përfaqësueses shqiptare, pasi nuk ka gjetur shumë hapësira me skuadrën e Goztepe, pritet të transferohet në një klub tjetër ku ka lënë shenjë edhe më parë në karrierën e tij. Sipas mediave turke, tashmë është drejt finalizimit marrëveshja për transferimin e sulmuesit në radhët e Akhisar Beledijespor, një tjetër klub i Superligës të cilin Çikalleshi e njeht mirë. Sulmuesi i cili në Turqi ka luajtur edhe për Bashkashehir, Osmanlispor e së fundmi Goztepe, ka qenë pjesë e Akhisar Beledijespor në pjesën e dytë të sezonit 2016-2017 duke luajtur atje me

Sokol Çikalleshi kthehet te Akhisarspor



Akhisar ekibine G...

eshi me këtë skuadër, arriti të shënonte 7 gola, ndaj nuk është aspak për t'u çuditur që në klubin turk kur kanë mësuar se ai mund të largohet nga Goztepe, kanë shpejtuar që të sigurohen të nënshkruajnë me 28-vjeçarin për të cilin ajo eksperiencë ishte më e mira në futbollin turk. Pritet që burokracitë e firmës të mbyllën në ditën më vijim, ndërsa nuk është e qartë nëse do të kalojë përsëri si huazim apo në formë përfundimtare te skuadra, e cila mban vendin e 15 në Superligën turke dhe ka nevojë për ndihmën e sulmuesit shqiptar që në këtë sezon të sigurojë mbijetesën.

Siti rruhd dorën në merkato

Gurdiola: Nuk shpenzoj 100 mln për një mesfushor

Një nga synimet që Manchester Siti kishte në merkaton e vers, ishte mesfushori i Uolvestit, Ruben Navas për të cilin, mediat raportojnë se vlera e tij arrin në 100 milionë paund. Kjo shifer, duket si e përballeshme nga Manchester Siti, por vetë trajneri Pep Guardiola u shpreh për mediat se nuk do të bënte një transferim të tillë. Ai tha në konferencën për shtyp se edhe shpenzimet e merkatos duhet të kenë një limit dhe se nuk mund të paguajë një shumë të tillë për një mesfushor. Në fakt, kjo është një deklaratë disi e çuditshme duke qenë se shifra të tilla janë kthyer në modë tashmë te Siti, madje edhe për mbrojtës. "Një muaj më parë kam lexuar se Neves kushton 100 milionë paund. Në nuk mund të paguajmë një shumë të tillë për një mesfushor, gjithçka e ka një limit, kështu që do të duhet vëmendje maksimale në zgjedhjen e lojtarëve për sezonin e ardhshëm", - u shpreh Guardiola.




SULMUESI SPANJOLL

Morata shmang Milanin, preferon Seviljen

E ardhmja e sulmuesit spanjoll, Alvaro Morata, është larg Çelsit, kjo është e qartë. Tani pritet të mësohet zyrtarisht se ku do të kalojë ai, në Spanjë apo Itali. Për momentin, shanset më të mëdha i ka Atletico Madrid, që sipas "As", e ka prioritet sulmuesin. Kanë dështuar bisedimet me Seviljen, pasi klubi andaluzian nuk e përballohet koston e lartë, ndaj dhe Morata duket më pranë "colchoneros". Ai e ka ndarë mendjen për t'u larguar nga Londra dhe e ka bërë të qartë se është i gatshëm të ulë edhe rrogën prej nëntë milionë eurosh në sezon për të arritur akordin me ekipin e ri. Kjo do të thotë se Milani nuk ka më shpresa për sulmuesin spanjoll.

Fjalëkryqi (1)




- 37. Italia në Internet.
 - 38. Fillojnë vonë.
 - 39. Krijoi James Bond.
 - 40. Ishulli i Odiseut.
 - 42. Van der portier.
 - 43. Një karamelle aromatike.
 - 44. Mund të shkojnë... nga frika.
- VERTIKAL**
- 1. Bëhet duke vënë në lojë.
 - 2. Pak origjinale.
 - 3. Thahet me bonifikim
 - 4. Në fund djathtas.
 - 5. Ishte Gjermania e Honecker-it.
 - 7. Hidhet një për shesh.
 - 9. Kokëkuqja në pit stop.
 - 10. I famshëm ai i Sizifit.
 - 12. Eshhtë në pikën më veriore e Shqipërisë.
 - 13. Një diktator shtypës

- VERTIKAL**
- 1. Të çara ato të Shollohov.
 - 5. Fillojë luftën.
 - 8. Liszt kompozitor.
 - 6. Marsi në Areopag.
 - 9. Kështu fillon filmi.
 - 11. Gjysmë linear.
 - 12. Një freskues në tavan.
 - 18. Eshhtë gazeta Panorama.
 - 20. Mund të jenë kamikaze.
 - 21. Masat pa kufij
 - 23. Venier e spektaklit italian.
 - 25. Sophia e kinemasë.
 - 26. Safin tenist.
 - 29. Eshhtë makut, i pangopur.
 - 31. Eshhtë faqe ene.
 - 32. Një kalshë që hap... galeri.
 - 33. Një fytyrë e keqe.
 - 35. Preken nga sindroma Basedow.

- 14. Lëvizja Socialiste Spanjole.
- 15. I kanë çift radhët.
- 16. Janë llahtarë.
- 17. Poeti kur nuk pi.
- 19. Fillojnë periudhën.
- 22. Omar që qe aktor.
- 24. Si sezonale.
- 25. Janë banorët në Riga.
- 26. Carey këngëtare.
- 27. Nuk i tregohën babait.
- 28. Bëjnë arte me re.
- 29. Kush ka... e ka humbur toruan.
- 30. Një stacion orbital.
- 31. Fillojnë profesionin.
- 33. Gibemau i MotoGp.
- 34. I kanë të ndryshme tutat
- 36. Gjysmë ditar.
- 38. Varet me re.
- 41. Kufijtë e kuqtesës.
- 42. Sapo fillojnë.

Fjalëkryqi (2)




- HORIZONTAL**
- 1. Gustav kompozitor.
 - 6. Në krye të kryesisë.
 - 7. Lexohet në pentagram.
 - 11. Sastre aktore.
 - 12. Gjysmë akordi.
 - 15. Dhjetë angleze.
 - 16. Satira për zë.
 - 18. Eshhtë situata e tensionuar.
 - 21. Pak teatrale.
 - 22. Bëhet me mea culpa.
 - 24. Fundi i një samurai.
 - 25. Mbeten në fund.
 - 26. Lind në kokë.
 - 28. Në radhë të parë.
 - 29. Iniciale e Camus
 - 30. Një verë në Paris.
 - 31. Partizani i vogël... në një film tonin.
 - 33. Litra pa kufij.
 - 35. Eshhtë fatë.


- 36. Një pjesë e kinematografisë.
- 37. Një pjesë e akademisë.
- 39. Kufijtë e tretjes.
- 40. Mbyll të çarën.
- 41. Erik çiklist.
- 43. Një pjesë e medaljes.
- 44. Njësi matëse e shpërthimit atomik.
- 46. Pak torturuese.
- 48. Ka privilegjin e jetës
- 51. Mbyllin një spital.
- 52. Mbylltet me dorezë.
- 53. Ishin kalorësit si Rolandi
- 54. Ndal në... kryqëzim.

- VERTIKAL**
- 1. Janë enigmatikë.
 - 2. Mund të jenë parabolike.
 - 3. Ishte xhelozja e Olimpiti.
 - 4. Kufijtë e lëvizjes.
 - 5. Fillojnë radhitjen.
 - 6. Janë kushte.
 - 8. Totem pa ekstreme.
 - 9. Mbyllin kanate.
 - 10. Shoqëronte Edipin e verbër.
 - 13. Eshhtë gjeli.
 - 14. Moore aktore.
 - 17. Janë forcat e Reneas.
 - 19. Janë përmasa.
 - 20. Fund dhjetori.
 - 23. Mbyllin dritaren.
 - 26. Fillojnë matjet.
 - 27. Duhet ruajtur.
 - 32. I bën një serenatë Rosina-s.
 - 34. Gjysmë rabini
 - 38. Mustafa.. Atatürk.
 - 40. Të parat në Amsterdam.
 - 42. Ai i muzave është Helikona.
 - 45. Një pjesë e gadishullit
 - 47. Muzika e Eminem.
 - 49. Fillojnë operacionin.
 - 50. Kapen të parat.
 - 52. Kufijtë e drejtëzës.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

F	E	T	E	R		P	A	M	O	R	E
A	M	E	N	K	B	A	N	O	R	E	T
R	A	M	I	T	A	E	D	E	M	A	T
P	I	E	A	N	A	T	E	M	A	T	T
R	I	E	L	E	P	A	T	I			
E	K	O	N	O	M	I	K	E	R	E	S
K	E	N	E	T	A	T	R	O	B	E	R
E	M	R		E	H	R	O	M	B	I	
S	I	N	G	E	R	I	N	A	T	I	N
S	A	J	I	D	I	T	E	R	I	T	M
S	H	I	N	E	N	E	M	I	R		
D	A	M	A	R	I	A	K	T	E	T	E
S	P	O	T	P	B	A	A	L	F	E	A
A	S	O	P	E	R	E	T	A	T	A	S
U	O	P	E	R	A	T	D	O	R	A	
L	I	P	L	I	P	O	T	I	M	I	A
M	O	N	O	T	O	N	I	I	R	O	N
L	I	Z	T	O	R	T	I	L	O	N	
A	T	I	A	N	T	E	U	E	N	I	
D	I	T	A	T	I	L	O	M	I	S	
A	M	A	N	E	T	A	L	G	A	T	F
E	I	R	I	S	A	R	E	N	E		
S	T	O	L	I	K	U	R	A	T	A	R
P	M	A	K	E	T	E	L	E	H	T	E

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOKU

			3		1					2	
9			5	3						4	
	8					2	3	6			
5	7	4	9								
			4	2	8					3	
		8	7	4	3						
						2	8				
											4

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

5	6	8	7	9	1	4	3	2
9	7	3	8	2	4	5	6	1
4	2	1	3	5	6	7	8	9
8	1	2	5	3	7	9	4	6
7	5	6	9	4	2	8	1	3
3	4	9	6	1	8	2	5	7
1	8	4	2	7	3	6	9	5
2	3	5	4	6	9	1	7	8
6	9	7	1	8	5	3	2	4

Argëtim filozofik

- Më mirë është të meritosh e mos të fitosh, sesa të fitosh e të mos meritosh.

- Asnjëherë mos debato me një budalla. Një tjetër që mund të jetë duke shikuar, nuk do të dijë të bëjë diferencën.


- V.I.P është një qënie që punon si mushkë gjithë jetën që të bëhet i njohur, pastaj mban syze të errëta që të mos e njohin.

- Mos u mendo të bëhesh njeri i suksesshëm por më mirë të bëhesh i vlefshëm.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



Thënie të mençura

- Nëse nuk tregon të vërteten për veten nuk mund të tregosh dot as për të tjerët.
- Kush jeton sipas të gjitha rregullave humb gjithë kënaqësitë.
- Çmenduri është të bësh gjithmonë të njëjtën gjë dhe të presësh rezultate të ndryshme.

- Disa njerëz janë shumë të varfër, gjithçka që ata kanë janë paratë.
- Që ti thuash të vërtetën dikuj që nuk të kupton, ndonjëherë është më keq sesa ta gënjesht.
- Forca e vullnetit është ajo që ju detyron të fitoni, kur logjika juaj thotë se ju kenë humbur.

